

# Gazetarët e rinj si një shans për një erë të re të medieve me integritet dhe ndikim

---

Sashka Cvetkovska  
Dragan Sekullovski  
Ana Petrusheva





# **Gazetarët e rinj si një shans për një erë të re të medieve me integritet dhe ndikim**

---

Sashka Cvetkovska  
Dragan Sekullovski  
Ana Petrusheva

Qershor, 2021

# Impresumi

**Naslov na originalot:**

Младите новинари како шанса за нова ера на медиуми со интегритет и влијание

Сашка Цветковска, Драган Секуловски, Ана Петрушева

**Titulli:**

Gazetarët e rinj si një chans për një erë të re të medieve me integritet dhe ndikim

**Redaktor dhe autor:**

Sashka Cvetkovska

**Autorë:**

Dragan Sekullovski

Ana Petrusheva

**Bashkëpunëtorë:**

David Ilieski

Sunai Sabrioski

**Botues:**

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë

**Koordinimi:**

Daniel Braun

Davor Pashoski

**Përktheu:**

Benjamin Arifi

**Përgatitja kompjuterike dhe shtypja:**

Vinsent Grafika SHPK Shkup

**Tirazhi:**

50 kopje

**Ky publikim mund të shkarkohet pa pagesë në:**

<https://www.kas.de/mk/web/nordmazedonien>

<https://znm.org.mk/>

**Vërejtje:**

Fondacioni Konrad Adenauer dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë nuk mbajnë përgjegjësi për qëndrimet e dhëna në këtë publikim. Këto janë qëndrime personale të vetë autorit.

Ky publikim shërben vetëm për qëllime informative. Nuk guxon të përdoret në kuadër të fushatave zgjedhore.

# Gazetarët e rinj si një shans për një erë të re të medieeve me integritet dhe ndikim

---

Sashka Cvetkovska  
Dragan Sekullovski  
Ana Petrusheva

# Pëmbajtja

---

<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
--------------	----------

---

<b>ROLI I GAYETARËVE TË RINJ DHE SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHEN NË KONTEKST LOKAL</b>	<b>13</b>
--	-----------

---

Formulimi i problemit.....	15
Lëndë e hulumtimit.....	18
Rezultatet e analizës së bazuar në pyetësor të zhvilluar dhe qëndrime.....	19

<b>ROLI I ORGANIZATAVE TË PAVARURA NDËRKOMBËTARE MEDIATIKE NË KRIJIMIN E LIDERËVE MEDIATIK NË MAQEDONINË E VERIUT</b>	<b>25</b>
---	-----------

---

Standardet si një forcë transformuese nëpër redaksi.....	27
Si krijonin inkubatorë talentësh redaksitë e viteve të 90-ta.....	29
Përvoja e BIRN-it: mbrojtja e standardeve nëpërmjet aftësive për liderët e ardhshëm mediatik .....	31
Aftësi, aftësi dhe vetëm aftësi.....	33
Në hap me botën.....	34

<b>INKUBATORË TË RINJ INOVATIV TË TALENTËVE: SKENË E PAVARUR MEDIATIKE</b>	<b>37</b>
--	-----------

---

Nëpërmjet inovacioneve në qasje deri tek mediat me integritet.....	39
Përvoja e OCCRP.....	41
Pajisja me aftësi analitike: infrastrukturë kritike për secilin medium.....	44

<b>KRIJIMI I NJË INFRASTRUKTURE KRITIKE PËR SECILIN MEDIUM APO PAJISJA ME AFTËSI ANALITIKE NË TRE FAZA</b>	<b>45</b>
--	-----------

---

Teknika të kërkimi dhe mbledhjes së informacioneve.....	47
Kërkimi i informacioneve të qasshme publike online.....	47

Kërkimi i kompanive dhe personave.....	48
Mbledhja e informacioneve offline.....	49
Si të arrijmë deri tek informacionet që nuk janë në internet.....	50
Procedura për lëshimin e kërkesë për qasje deri tek informacionet.....	50
Si t'i gjeni poseduesit e informatave.....	51
Ku ta gjeni formularin për kërkesë për informata me karrakter publik.....	51
Si të pyesni?.....	51
Asnjë pyetje nuk fillon me sa, si dhe përse?.....	51
Si ta dimë se cili dokument e përmban atë që na nevojitet.....	53
Si të parashtroni pyetje deri tek Bashkimi Evropian.....	54
Organizimi i hulumtimit.....	54

---

<b>KONKLUZA DHE MESAZHE ME INTEGRITET</b>	<b>57</b>
---	-----------

---

<b>REZYME</b>	<b>71</b>
---------------	-----------

---



**Hyrje**

---





## Hyrje

---

Ata janë simbol i mburrjes dhe guximit rinor. Bob Vudvard dhe Karl Bernshtajn janë emrat më të njohur në historinë e gazetës amerikane “Washington Post”. Në vitin 1973, që të dy më pak se 30 vjeç (Vudvord 29 dhe Bernshtajn 28), u bënë gazetarët më të famshëm në botë pasi që e zbuluan aferën “Watergate”<sup>1</sup>. Raportimi i tyre solli deri tek një seri e hulumtimeve qeveritare ndërsa në fund nxiti edhe dorëheqjen e ish presidentit amerikan Riçard Nikson. Në katër dekadat e “Watergate”-it janë bërë një numër i madh filmash që ishin inspiruar nga ky hulumtim, ndërsa Dasting Hofman dhe Robert Redford ishin Vudvord dhe Bernshtajn në filmin “All the president men”

Potenciali i moshës së të rinjve në botë tashmë ka ndryshuar. Tregimet e rëndësishme nga bashkësitë tashmë i punojnë edhe nxënësit e shkollave të mesme të cilët me një mentorim të mirë po korrin rezultate, dhe më e rëndësishmja, që po arrijnë të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në bashkësitë lokale.

Medi Bajden, Trina Poll, Patrik Salivan, Kali Ponicki dhe Konor Baltazar , janë gjashtë nxënës të shkollës së mesme nga Kanzasi<sup>2</sup>, të cilët si gazetarë të gazetës së shkollës, do të zbulojnë se drejtoresha e re ka një biografi të kontestueshme, dhe kështu, do të nisin një luftë me bordin e shkollës të cilën do ta fitojnë. Ka qenë praktikë që kur të emërohet drejtoreshë e re në shkollë, Medi Bajden do të shkruante tekstin e mirëseardhjes për drejtoreshën, duke e prezantuar se kush është.

Por, portreti i thjeshtë shumë shpejtë u shndërrua në kategorinë gazetari hulumtuese pasi që 16 vjeçarja Medi do të vërejë dallime mes përgjigjeve të intervistës dhe biografisë formale të drejtoreshës Ejmi Robertson.

Ajo e ka përshkruar veten si dikush me “përvojë dekadëshe në arsim, që përfshin përvojat më të mira si mësues dhe administrator”. Autoritetet lokale janë impresionuar, por Medi insistonte që t’i verifikojë dyshimet. Ajo i thërret edhe pesë nxënësit e tjerë dhe së bashku do t’i hulumtojnë të gjithë të dhënat nga biografia e drejtoreshës.

---

1 Publikim i WashingtonPost , 14.06.2012, [https://www.washingtonpost.com/lifestyle/style/as-years-go-by-watergate-drifts-toward-myth/2014/06/14/cff4080c-aa8a-11e1-b15f-a61fa9b4d76\\_story.html](https://www.washingtonpost.com/lifestyle/style/as-years-go-by-watergate-drifts-toward-myth/2014/06/14/cff4080c-aa8a-11e1-b15f-a61fa9b4d76_story.html)

2 Lidhëse nga kumtesa e CBS News, 05.04.2017 <https://www.cbsnews.com/news/amy-robertson-resigns-after-student-reporters-investigate-her-credentials-pittsburg-high-school/>

Ata do të arrijnë të zbulojnë se universitetet prej të cilëve ajo ka diploma, janë mburojë për diploma të rrejshme dhe nuk ekzistojnë në realitet. Fillimisht këtë gjë e denoncojnë tek mbikëqyrësit e shkollës, por ata i refuzojnë këto gjetje me mosbesim. Megjithatë nxënësit vazhdojnë të punojnë në këtë hulumtim. Katër ditë pas publikimit, Robertson do të detyrohet që të dorëhiqet, ndërsa storja për gjashtë gjimnazistët do të shndërrohet në storje kombëtare që do ta festojë guximin, integritetin dhe aftësinë e të rinjve.

Sot, në vendet e zhvilluara të botës, të rinjtë janë të kyçur në prodhimin e gazetarisë kualitative, edhe atë në një mënyrë të dukshme, që vlerësohet si jetike për mbijetesën e bashkësive. Kjo arrihet nëpërmjet trajnimeve të ndryshme të organizuara nga institucionet mediatike, programet rinore në redaksitë lokale, gazetatat shkollore, podkastet dhe platformat e ndryshme digjitale.

Gazetaria rinore është zgjidhja e problemit për idetë që do t'i transformojnë bashkësitë, qytetet, shtetet, në kohën e tyre. Po, edukatorët duhet të kyçen më shumë, por mediet duhet të insistojnë edhe më shumë për një bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe të rinjve nëpër bashkësi. Jo vetëm që ka nevojë për përkrahje të gazetarëve të rinj nëpër bashkësi për të raportuar për tregimet dhe problemet që i tangojnë, por kjo është edhe një mundësi e madhe që të rinjve tu jepen detyra për të punuar dhe promovuar dialogun dhe vetëdijen për dallimet në nivel global.

Në dekadën e fundit, e sidomos në tre vitet e fundit, shumë prej strategjive kyçe të qeverive dhe programeve private donatore, e vendosën gazetarinë e të rinjve në listën e prioriteteve. U formuan shumë iniciativa për njohuri mediatike dhe për momentin në rajon po zhvillohen 100 projekte të tilla. Por edhe bashkësia akademike gjithnjë e më shumë flet për nevojën e njohurive mediatike dhe gazetarinë e të rinjve që duhet të bëhen komponentë e integruar në arsimin e të gjithë botës.

Gjithë kjo është e ekzekutueshme. Teknologjia dhe mjetet online e kanë bërë gazetarinë shumë më interaktive dhe më pjesëmarrëse për publikun lokal, kombëtar dhe global. Me teknologjitë online, redaksitë kanë mundësi që prej gazetarëve të rinj, të krijojnë shumë më shumë se sa vetëm raportues për lajmet lokale. Të rinjtë sot kanë diçka që nuk kanë patur ato para 10, 20 dhe më shumë vitesh – mundësi për tu lidhur me botën shumë shpejtë.


Të rinjtë e ditëve të sotme si asnjë gjeneratë më parë, e kanë mundësinë që të diskutojnë për hulumtimet e tyre dhe të kenë interaksion, vlerësim dhe shkëmbim idesh me bashkëmoshatarët nga gjithë bota. Shfrytëzimi i të rinjve në prodhimin e storjeve gazetareske është një gjë, por mundësia më e madhe për nxitjen e

ndryshimeve nëpërmjet gazetarisë sot qëndron në lidhjen globale: Përgatitjen e gjeneratës së ardhshme të qytetarëve të botës të cilët do të kenë aftësi, kuptim dhe guxim për t'i zgjidhur problemet globale të ditëve të sotme në kohën e tyre.

Amanda Gorman e cila lexonte poezinë e saj gjatë inaugurimit të presidentit amerikan Xho Bajden, gjatë një intervistë ka thënë se të rinjtë e sodit janë më të shqetësuar për ardhmërinë e botës dhe tashmë po i sjellin ndryshimet.

*“Do thosha se rinia e ditëve të sotme tashmë është bartëse e ndryshimeve dhe e asaj që na pret nesër! Mendoj se lëvizjet që po i shohim e që janë të udhëhequra nga të rinjtë – lëvizja për ndryshime klimatike, Marshi për jetët tona dhe rryma të caktuara nga Black Lives Matter – janë pa dyshim të përmirësuara falë energjisë së pamëshirshme dhe kuptimit historik të kësaj gjenerate. Ata tashmë vijnë me kuptim më të mirë të mangësive tona nga e kaluara, sidomos ekskluzivitetin në lidhshëm me liderhipin social dhe nuk e kanë ndërmend që t'i përsërisin të njëjtat gabime në të ardhmen”* – ka thënë poetja dhe aktivistja 22 vjeçare për të drejtat e njeriut.





**Roli i gayetarëve të rinj dhe  
sfidat me të cilat  
ballafaqohen në  
kontekst lokal**

---



# Roli i gayetarëve të rinj dhe sfidat me të cilat ballafaqohen në kontekst lokal

---

## Formulimi i problemit

Një prej anëve pozitive të profesionit të gazetarit është që asnjëherë nuk është vonë për tu bërë gazetar profesionist. Nëpër vendet demokratike, gazetaria është profesion i lirë, e kjo do të thotë se shteti për këtë profesion nuk jep licenca dhe nuk është një profesion që rregullohet në kuadër të odave dhe me licenca, por nëpërmjet sindikatave edhe atë në bazë vullnetare. Kjo është kështu pasi që gazetarët punojnë në shërbim të qytetarëve, ndërsa e drejta për informim është e rëndësishme pasi që në këtë mënyrë qytetarët bëhen të vetëdijshëm për kontekstin në të cilin jetojnë dhe për ato që krijojnë politikat, dhe nëse ato mundësojnë kualitet dinjitoz për jetë për të gjithë apo jo. Prandaj, para së gjithash ekziston një konflikt etik interesi, ata që janë në pushtet të kenë fuqi për të treguar se kush është gazetar e kush jo, pasi pikërisht ato, bartësit e funksioneve publike dhe të zgjedhurit e popullit, duhet të jenë lëndë e mbikëqyrjes kritike nga ana e gazetarëve dhe tu kërkohet përgjegjësi dhe llogari.

Ana pozitive e profesionit të gazetarisë në një kontekst më të gjerë është pikërisht kjo, liria dhe qasja e lehtë e secilit që ka dëshirë dhe mundësi që të bëhet gazetar. Motivi për të nisur karrierë në gazetari është pikërisht mundësia për ndikim për një shoqëri më të mirë dhe jetë më kualitative për qytetarët.

*Por, çfarë nëse liria e medieve është e kërcënuar ndërsa një pjesë e gazetarëve punojnë në kushte të këqija dhe të pa sigurta të punës?*

Një prej përgjigjeve të kësaj pyetjeje e jep edhe nobelisti i njohur i shekullit të kaluar Albet Kamy i cili thotë: “Mediet e lira mund të jenë të mira apo të këqija, por gjithsesi, pa lirinë e medieve, asnjëherë nuk do të jetë asgjë tjetër përveç se keq”.<sup>3</sup>

Ana negative e gazetarisë në kontekst lokal është politika e mosndëshkimit për sulmet ndaj gazetarëve, procedurat gjyqësore kundër tyre që lidhen me punën që e bëjnë, paratë publike në mediet ku punojnë e që ndikojnë në politikën redaktuese, pagat e ulëta dhe kushtet jo të mira të punës. Këto janë vetëm disa nga

---

3 Citim i Albert Kamy-së i disponueshëm në <https://exit.al/en/2020/05/03/world-press-freedom-day-2020-some-of-the-worlds-most-famous-media-freedom-quotes/>



faktorët që ndikojnë negativisht në pavarësinë e shumicës së medieve por edhe jo popullaritetin e profesionit të gazetarisë, para së gjithash tek të rinjtë.

Përveç kësaj, ka shumë shembuj për gazetarë kritik dhe punonjës mediatik që kanë qenë pre e fushatave publike që kanë pasur për qëllim diskreditimin e tyre në mënyrë që të zbutet ose të humbet vlera e kritikës së tyre në sytë e opinionit.

Këto fushata që janë një mjet i presionit dhe tentativë për nënçmim që shpesh herë kanë pasur edhe narrative partiako-politike, ndikojnë në mënyrë shtesë në edhe ashtu imazhin e ulët të bashkësisë gazetareske. Kjo ka ndikuar që ky profesion ta humb edhe popullaritetin para opinionit publik, ndërsa kjo gjendje i shkon për shtati secilit pushtet pasi që kështu e ka më të lehtë që të ballafaqohet me kritikën publike.

Gazetarët e rinj dhe në përgjithësi punonjësit mediatik, pavarësisht se a bëhet fjalë për kameramanë apo fotoreporterë, po bëhen një pakicë serioze nëpër redaksi, dhe kjo është e dukshme sidomos tek mediet tradicionale siç janë televizionet, radiot dhe mediet e shkruara. Për momentin nuk ekziston një informacion për strukturën e moshës nëpër medie, dhe nuk ka një analizë prej Agjencisë së Medieve<sup>4</sup>, apo sektorit civil për atë se sa gazetarë të rinj punojnë nëpër redaksitë gjithandej shtetit. Por, për nevojat e këtij publikimi dhe duke u nisur nga motivi për formimin e një seksioni të gazetarëve të rinj në kuadër të SHGM-së, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë gjatë muajit mars të vitit 2021 realizoi një anketë në më shumë medie me qëllim që të bëhet vlerësimi i këtyre kuadrove. Në këtë anketë **janë shënuar 107 gazetarë të rinj, pra gazetarë që janë nën moshën 33 vjeç dhe kanë një angazhim të rregullt pune në ndonjë medium, apo janë të angazhuar përkohësisht me kontratë në vepër. Duke marrë shifrën totale të gazetarëve në nivel shteti që sipas llogaritjeve të SHGM-së është rreth 1000, supozohet se 10 deri 15 për qind nga numri total i gazetarëve janë të rinj (nën 33 vjeç) ndërsa të tjerët janë në mes të karrierës apo shumë të rritur.**

Dallim shumë të madh në aspektin e moshës ka edhe në servisin publik, në Radio Televizionin e Maqedonisë, si dhe në Agjencinë shtetërore të lajmeve MIA. **Kështu në RTVM prej 713 të punësuarve të regjistruar më 31.12.2020, në TVM1 TVM2 dhe redaksitë e gjuhëve të tjera dhe radio në maqedonisht, ka vetëm 13 gazetarë të rinj dhe vetëm një kameraman, apo gjithsej 14. Ndërsa në MIA prej 98 të punësuarve në vitin 2020, gazetarë të rinj nën moshën 33 vjeç janë vetëm 13<sup>5</sup>.**

4 Informatë e marrë nga shërbimet profesionale të ASHAAM nga muaji mars i vitit 2021

5 Informatë e marrë nga intervista me persona kompetent në RTM dhe MIA në muajin mars të vitit 2021

Përveç tek mediet, në mesin e të rinjve mungon edhe vullneti për tu regjistruar në studimet e gazetarisë. Kështu për shembull **në Fakultetin Juridik Justiniani I I në Shkup, në vitin 2020 në semestrin e parë janë regjistruar gjithsej 8 studentë, ndërsa në studimet universitare për gazetari në Universitetin Goce Dellçev në Shtip, në vitin 2020, janë regjistruar vetëm pesë studentë. Prej tyre, vetëm dy të rregullt ndërsa tre me korrespondencë.** Në fakultetin e tretë, në Universitetin shtetëror të Tetovës ku po ashtu ekziston katedër për gazetari dhe media, **në vitin 2020 janë regjistruar shtatë studentë prej të cilëve pesë janë të rregullt dhe dy me korrespondencë.**

Sa për krahasim me të kaluarën, në Fakultetin Juridik në Shkup ku ka një katedër inter-disciplinare për gazetari, **gjatë vitit 1977 kur është formuar kjo katedër, gjenerata e parë ka numëruar 125 studentë.** Por edhe gjatë viteve gjeneratat e reja kanë qenë me po ashtu qindra studentë të regjistruar. Në kuadër të programit studimor të Universitetit Goce Dellçev që ishte formuar **në vitin 2009, në gjeneratën e parë janë regjistruar 61 studentë** ndërsa në vitet e tjera mesatarisht ka pasur rreth 50 studentë të regjistruar për çdo vit akademik<sup>6</sup>.

*Cilat janë arsyet kryesore përse profesioni i gazetarisë po bëhet gjithnjë e më pak atraktiv dhe si mund të ndikohet për përmirësimin e situatës?*

Ka më shumë arsye, por kryesisht ato mund të ndahen në arsye të shkaktuara nga ndikime të jashtme dhe të brendshme. Arsyet e **jashtme** kanë të bëjnë me tregun e vogël dhe numrin e madh të medieve të cilat tentojnë të ekzistojnë dhe kjo është si pasojë e standardit të ulët ekonomik në profesionin e gazetarisë që është i pranishëm në thuajse të gjitha mediet. Në mënyrë plotësuese, presionet e **jashtme** ndaj gazetarëve dhe medieve kritike nga ana e partive politike, qendrave të biznesit por edhe institucionet publike, i dekurajojnë gazetarët nga kontinuiteti i të qenurit në këtë profesion. Sa l përket arsyeve të brendshme, njëra prej tyre është se si menaxhohen mediet, kjo pasi në shumë media tradicionale pagat e gazetarëve janë tejet të ulëta dhe nuk respektohen të drejtat punonjësve mediatic. Në këtë drejtim si një argument plotësues është fakti që sipas analizave të Sindikatit të pavarur të gazetarëve dhe punonjësve mediatic, në shumë media të mëdha private, nuk ekzistojnë marrëveshje kolektive nëpërmjet të cilave në mënyrë plotësuese do të zbatoheshin të drejtat e punëtorëve dhe faktin se paga mesatare e gazetarëve është më e vogël se sa paga mesatare në nivel shteti<sup>7</sup>.

6 Informatë e marrë nga intervista me të punësuar në Universitetin e Shtipit

7 Anketë e Sindikatit të pavarur të gazetarëve dhe punonjësve mediatic nga 31.08.2017, e disponueshme në <https://ssnm.org.mk/komentari/%D0%BF%D0%BB%D0%B0%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BE-%D0%BC%D0%B5%D0%B4%D0%B8%D1%83%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5-%D0%B7%D0%B0%D0%B3%D0%BB%D0%B0%D0%B2%D0%B5%D0%BD%D0%B0-%D0%BF%D0%BE%D0%B4-%D0%BF%D1%80>

## Lëndë e hulumtimit

Lëndë e këtij hulumtimi është që të bëjë vlerësim të statusit dhe nevojave të kuadrove të reja në industrinë mediatike të Maqedonisë së Veriut, si dhe theksimi i shembujve pozitiv për inkluzivitet dhe ndërtim të kapaciteteve brenda redaksive të gazetarëve të rinj dhe punonjësve mediatik.

Në **pjesën e parë** të këtij publikimi, fokusi është në vlerësimin e numrit të gazetarëve të rinj që janë nën 33 vjeç<sup>8</sup>, pavarësisht se a kanë një angazhim të rregullt apo janë të angazhuar me marrëveshje të përkohshme edhe atë në mediet tradicionale dhe ato online që janë në territorin e të gjithë vendit<sup>9</sup>. Për këtë qëllim, SHGM realizoi një anketë telefonike me anëtarët e saj që janë nga media të ndryshme të mëdha gjithandej shtetit, por edhe me gazetarë nga mediet online që janë pjesë e regjistrit të medieve profesionale online, në gjashtë qendrat rajonale SHGM-së në Strumicë, Shtip, Kumanovë, Tetovë, Ohër dhe Manastir, si dhe nëpërmjet Shoqatës së medieve të shkruara, servisit publik TVM dhe MIA. Numri total që ka rezultuar prej kësaj ankete është 107. Përveç kësaj, në këtë pjesë jepet kontekst edhe për numrin e studentëve që janë regjistruar në programet studimore të gazetarisë, në tre universitetet shtetërore. Në mënyrë shtesë, elaborohen edhe arsyet që kontribuojnë që gjatë viteve të fundit profesioni i gazetarisë të bëhet më pak atraktiv për të rinjtë. Kjo pjesë përmban edhe rezultate të një pyetësori të realizuar në mesin e një grupi më të madh të gazetarëve të rinj nëpërmjet të cilëve bëhet tentativë për tu kuptuar nevojat e të rinjve në sektorin mediatik.

Në **pjesën e dytë** të këtij publikimi fokusi është edukativ dhe përcillet nga një redaktor me përvojë i cili ka praktikë të punës me gazetarë të rinj që hulumtojnë, shpjegohet procesi redaktues në një redaksi hulumtuese duke e krahasuar me kushtet e ditëve të sotme dhe ato të viteve më parë. Në këtë pjesë janë vendosur shembuj pozitiv për punë në redaksi me të cilat rritet efikasiteti i ekipit, dhe i njëjti përmban intervista me bashkëfolës jo vetëm nga shteti por edhe nga rajoni. Në mënyrë shtesë, në këtë pjesë shpjegohen disa programe për “on the job training” dhe domethënien e tyre duke e plotësuar me shembuj dhe bashkëbisedues. Për në fund, në këtë pjesë bëhet një rikujtim i gjendjes së tanishme dhe se si ajo ndikon në profesionin e gazetarisë dhe se si statusi në gazetari ndikon në standardet profesionale. Si shembull do të merret praktika e Rrjetit të Reporterëve Ballkanik për Hulumtim (BIRN), por jo vetëm në kontekst lokal por edhe nga praktikatat më të mira nga shtetet fqinje që ndikojnë në zhvillimin e produkteve gazetareske me kualitet të lartë, e që vlerësohen jo vetëm nga opinioni publik por edhe nga faktori ndërkombëtar.

8 Federata evropiane e gazetarëve ka praktikë që kur organizon trajnime për gazetarë të rinj vendosë kufi moshe deri në 33 vjeç.

9 Regjistri i mediave profesionale online - <https://promedia.mk/main>

Përmbajtja e pjesës së **tretë** ka për qëllim shpjegimin e procesit të punës së gazetarëve të rinj nëpër redaksitë huluntuese, me shpjegim të procesit të punës së brendshme sipas standardeve të Projektit për raportim për krimin e organizuar dhe korrupsionin (Organized Crime and Corruption Reporting Project- OCCRP)<sup>10</sup>, i themeluar në vitin 2006. Kjo platformë e përbashkët për bashkëpunim është konzorcium i qendrave të hulumtimit, medie dhe gazetarëve që punojnë në Evropën Lindore, Kaukaz, Azinë Qendrore dhe Amerikën Qendrore. OCCRP është organizatë për raportim huluntues që është e specializuar për krim të organizuar dhe korrupsion, dhe në këtë pjesë do të jepen shembuj konkret se si të rinjtë integrohen nëpër redaksi nëpërmjet trajnimeve brenda medias dhe nëpërmjet detyrave konkrete, nën mentorimin e gazetarëve më me përvojë. Përveç kësaj, pjesa e katërt do të përmbajë udhëzime se si gazetarët të jenë më të guximshëm dhe të motivuar në detyrat gazetareske, por duke ruajtur standardet më të larta etike dhe sigurinë personale. Motivimi i gazetarëve të rinj është kyç për redaksitë, prandaj nëpërmjet shembujve konkret do të shpjegohen disa teknika për ruajtjen e motivimit tek gazetarët e rinj. Do të prezantohet edhe një udhëzues i shkurtër për aftësitë kritike dhe analitike të cilat të rinjtë i fitojnë nëpër redaksi me programe për gazetarë të rinj.

## Rezultatet e analizës së bazuar në pyetësor të zhvilluar dhe qëndrime

Për nevojat e kësaj pjese është folur me profesorë dhe të punësuar në tre universitetet shtetërore në të cilat ekzistojnë drejtime për studime të gazetarisë, edhe atë në Shkup, Shtip dhe Tetovë. Dhe përveç kësaj, analizohet edhe një pyetësor i llojit gjysmë të hapur, me tetë pyetje, në të cilin gjatë muajit mars të vitit 2021 dhanë përgjigje 28 gazetarë të rinj.

Në tërësi, të gjithë universitetet gjatë viteve të fundit ballafaqohen me probleme të trendit në ulje të studentëve të ri që regjistrohen për gazetari. **Arsyet kryesore për shkak të cilave në këto tre universitete gjatë vitit 2020 janë regjistruar gjithsej 20 studentë**, janë të ndryshme dhe fillojnë prej kurrikulave të vjetruara mësimore të gazetarisë, deficitin e kuadrit mësimor dhe mungesën e letërsisë akademike të qasshme para së gjithash në maqedonisht, por edhe në gjuhët e tjera në të cilat zhvillohet mësimi në shtet. Përveç kësaj, në një pjesë të programeve studimore të gazetarisë mungon puna praktike apo zbatohet shumë pak, dhe kjo për shkak të kufizimeve hapësinore dhe teknike, ndërsa dihet që kjo pjesë është tejet me rëndësi në mënyrë që gazetarët e rinj të jenë të përgatitur për të shkruar tekste gazetareske,

---

10 Organized Crime and Corruption Reporting Project – OCCRP, <https://www.occrp.org/en>

për të ushtruar leximin, për të mësuar se çfarë është e rëndësishme të dihet në praktikë për incizimin dhe montimin e një kronike, për zhvillimin e një interviste dhe ngjashëm. Përparësi në këtë drejtim ndoshta ka vetëm Universiteti i Shtipit i cili ka kushte teknike dhe hapësinore për praktikë të gazetarisë radio dhe televizive.

Përveç kësaj, Igor Stojanov i cili është kryeredaktor në drejtimin për radio dhe televizion në Universitetin e Shtipit ka shtuar se: *“Sipas meje, nuk ka një arsye të vetme për zvogëlimin e interesit të të rinjve për studimin e gazetarisë. Një prej arsyeve të shumta është rënia drastike e kualitetit të përmbajtjeve mediatike në Maqedoninë e Veriut. Jam i sigurt se kontakti i parë i studentëve të ardhshëm me profesionin janë vetë mediet të cilat ata i shohin si shikues, si publik. Para se të bëhen studentë ata janë publik. Duke shikuar përmbajtjet ata mund të shohin jo-profesionalizmin, partizimin dhe jo-objektivitetin, për dallim prej medieeve globale që sot janë të kapshme për të rinjtë nëpërmjet internetit”. Gjithsesi, përveç këtij perceptimi të të rinjve për mënyrën e punës së medieeve, një rrethanë tjetër e veçantë është edhe standardi, prandaj Stojanov shton se: “Arsye tjetër mund të jetë edhe mungesa e shtëpive mediatike që funksionojnë në pjesët lindore të shtetit dhe gjendja e tyre financiare. Me gjasë të rinjtë e shohin se puna në mediet e Maqedonisë së Veriut, e sidomos në pjesët lindore të shtetit, nuk ka leverdi. Edhe ne por edhe shumë organizata kanë bërë hulumtime për këtë gjendje. Të dhënat flasin se 90 për qind e gazetarëve në pjesën lindore të shtetit, marrin rroga që janë nën mesataren shtetërore. Dhe kjo është poshtëruese dhe e turpshme për profesionin.”*

Megjithatë në kryeqytet kërkesa në tregun mediatik do të duhej të ishte më e lartë pasi që thuhet të gjithë mediet kombëtare gjenden në Shkup, dhe kjo nënkupton se numri më i madh i gazetarëve janë të koncentruar në një vend. *“Tetë studentë të gazetarisë janë regjistruar në vitin e kaluar akademik gjatë afatit të parë. Arsye për këtë gjë është devaluimi i bashkësisë akademike e cila merret me çështjen e medieeve dhe gazetarinë, numri i lartë i doktorëve të shkencës në fushën e medias dhe pamundësia për tu punësuar, secili prezantohet si ekspert i medieeve pa asnjë cikël të kaluar edukimi në gazetari, dhe promovimi i kuazi analizave dhe ekspertizave që lidhen me tema në kontekst të medieeve dhe gazetarisë dhe ngjashëm”, janë motivet kryesore që ndikojnë në nivelin e ulët të motivimit për regjistrim në studimet e gazetarisë në universitetet shtetërore, sipas dr. Jasna Bačovska Nediq, profesor inordinar në Fakultetin Juridik në Shkup.*

Për nevojat e plotësimit të qëllimeve strategjike për vitin 2021 që përshin krijimin e një seksioni të gazetarëve të rinjë, por edhe për nevojat e këtij publikimi, SHGM ka zhvilluar një hulumtim në formë të anketës online në shqip dhe maqedonisht, i cili u është dërguar 80 gazetarëve nën 33 vjeç, nga 30 media të ndryshme gjithandëj territorit të Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i pyetësorëve ka qenë që të fitohen më shumë njohuri për nevojat e gazetarëve të rinj, për mbrojtje më efikase të të drejtave të tyre nëpër redaksi, si dhe për definimin e temave që janë me interes të përbashkët, për përmirësimin e kapaciteteve nëpërmjet ngjarjeve edukative në dhe jashtë vendit, si dhe për përmirësimin e solidaritetit mes tyre që është një parakusht për implementimin e politikave rinore në sektorin mediatik. Përveç kësaj, qëllim shtesë është edhe krijimi i një seksioni i gazetarëve të rinj në kuadër të SHGM-së, si fillim për një organizim të bashkuar që ka për qëllim dhënien e hapësirës për të rinjtë që ta rrisin bashkëpunimin mes vete, si dhe për tu ofruar platformë ku do të mund të shkëmbehen përvoja pozitive dhe negative nga profesioni, e që do të ishin lëndë e aktiviteteve të përbashkëta më tutje.

Pyetjet që janë pjesë e kësaj ankete janë të grumbulluara në këtë format:

1. Në çfarë mediumi punoni dhe si është marrëveshja juaj për punë?
2. Sa orë në ditë punoni mesatarisht dhe a keni praktikë që të punoni gjatë fundjavës apo festave?
3. A jeni të kënaqur nga të ardhurat e juaja mujore?
4. A mendoni se keni mjaftueshëm liri për sugjerim dhe përzgjedhje të temave për të cilat do të raportoni ?
5. Në sa trajnime që kanë qenë për përmirësimin e aftësive të juaja gazetareske keni qenë të kyçur? Sa prej këtyre trajnimeve kanë qenë të brendshme , në mediumin tuaj, të zhvilluara nga bashkëpunëtorët më me përvojë në formën e mentorimit?
6. Cilat kushte duhet përmirësuar në mënyrë që ju si gazetar të rinj të jeni më të motivuar?
7. Si mund të ndihmojnë organizatat gazetareske në shtet për përmirësimin e statusit të gazetarëve të rinj?

Në bazë të pyetësorëve të plotësuar nga anketa e realizuar, mund të konstatojmë se në hapësirën mediatike të shtetit, kryesisht punojnë gazetarë në moshë prej 21 deri 33 vjeç, që kanë përvojë pune prej 1 deri në 8 vite.

Në kontekst të orëve të punës së gazetarëve të rinj, dhe atë se a ndodhë shpesh që të punojnë edhe për fundjavë dhe festa, dhe më shumë se tetë orë në një ditë pune, përgjigjet janë kryesisht po, por të njëjtat ndryshojnë varësisht nga lloji i mediumit ku punojnë gazetarët. Kështu, gazetarët të cilët punojnë në mediet online, kryesisht nuk kanë orar pune prej tetë orësh, kjo pasi varet nga volumi i punës në një periudhë të caktuar. Ndërsa puna e gazetarëve që punojnë nëpër redaksi televizive dhe gazeta, punojnë kryesisht nga tetë orë në ditë, dhe ndonjëherë kanë edhe kujdestari gjatë fundjavave.

Ka qëndrime të ndara sa i përket çështjes nëse gazetarët e rinj janë të kënaqur nga lartësia e të ardhurave mujore. Kryesisht, gazetarët që janë përgjigjur në pyetësor dhe të punojnë në mediet online, janë të kënaqur, ndërsa gazetarët nga televizionet janë të pakënaqur nga të ardhurat e tyre mujore. Lidhur me lirinë e gazetarëve të rinj për sugjerimin e temave dhe përzgjedhjen e tyre, qëndrimi i përgjithshëm është se ata kanë liri për të propozuar tema dhe që pranohen nga redaktorët, por mbetet e panjohur se sa është praktikë e shpeshtë kjo dhe se sa gazetarët e rinj propozojnë tema për hulumtim apo raportim.

Lidhur me çështjen e pjesëmarrjes nëpër trajnime për përmirësimin e aftësive gazetareske, si dhe për trajnime të brendshme nëpër redaksi që udhëhiqen në formë mentorimi nga gazetarët më me përvojë, habit fakti që thuajse nuk ka trajnime të tilla, me përjashtime të rralla. Nuk dihet arsyeja e saktë, por supozimi është që faktori kryesor për këtë gjendje është puna dinamike nëpër media që rrallë lejon kohë të lirë për trajnime të brendshme, sidomos nëpër redaksitë më të vogla.

Në pyetësorin e anketës është shkruar se: *“Gjendja me përmirësimin e aftësive dhe krijimin e kapaciteteve të gazetarëve të rinj nëpër redaksi, qoftë në formën e trajnimeve të jashtme qoftë në formën e mentorimit nga ana e kolegëve më me përvojë brenda mediumit, është tejet alarmante. Madje është frustrues refuzimi i disa kolegëve më me përvojë për të ndihmuar në të ashtuquajturën modernizim apo përmirësim të aftësive të gazetarëve të rinj të cilët tek fillojnë të punojnë në redaksi”,* është theksuar nga një gazetar i ri që është përgjigjur në anketë.

Lidhur me ndërtimin e kapaciteteve të gazetarëve të rinj, gjatë përgjigjeve në pyetësor është vërejtur një koment që thotë: *“Ka nevojë për organizim dhe financim të aktiviteteve gazetareske jashtë vendit, në mënyrë që gazetarët e rinj në sferën e gazetarisë të mund të shkëmbejnë përvoja dhe dije dhe të pajisemi me njohuri të reja dhe shembuj pozitiv nga praktika jashtë shtetit ku jetojmë”,* ka theksuar një gazetar i ri që është anketuar.

Në pyetësor janë theksuar disa kushte që duhet të përmirësohen në të ardhmen, në mënyrë që të rritet motivimi i gazetarëve të rinj edhe atë:

- » Rritja e pagës duke u bazuar në punën shtesë gjatë festave dhe fundjavave,
- » Përmirësimi i aftësive dhe kompetencave të gazetarëve të rinj nëpërmjet organizimit të trajnimeve të brendshme dhe të jashtme,
- » Mentorim prej kolegëve më të vjetër, pranimi i sugjerimeve që ofrojnë freski në përmirësimin e punës brenda redaksisë, autonomi gjatë përzgjedhjes së temave, mos-përzierja e pronarëve në punën e mediumit.


Në kontekst të mënyrës në të cilën organizatat gazetareske në shtet mund të ndihmojnë në përmirësimin e statusit të gazetarëve të rinj, janë theksuar disa gjëra siç janë organizimi I aktiviteteve të përbashkëta si për shembull organizimi I trajnimeve që do të ndërtonin kapacitetet e gazetarëve të rinj nëpër redaksi, duke organizuar ngjarje dhe aktivitete të ndryshme por edhe duke promovuar tema që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve të rinj dhe mbrojtjen e të drejtave autoriale, gjë që po paraqitet si problem gjithnjë e më shumë. Shoqatat e gazetarëve gjithashtu mund të ndihmojnë edhe duke ofruar mjete afatshkurtra për përpunimin e storjeve për gazetarë që nuk janë të punësuar për momentin, tu dalin në ndihmë gjatë kërkimit të punës, dhe sigurisht nëpërmjet formimit të një seksioni për të rinjtë në kuadër të SHGM-së ku do të mbahen takime të shpeshta, dhe kështu të bashkuar të veprojnë për zgjidhjen e sfidave me të cilat ballafaqohen të rinjtë çdo ditë pas mbarimit të arsimit formal.

Prej përgjigjeve të marra nga ana e gazetarëve të rinj nëpërmjet pyetësorit anketues, mund të konstatojmë se iniciativa për tu formuar një seksion I gazetarëve të rinj në kuadër të SHGM-së është përshëndetur fort dhe është mbështetur nga të rinjtë, me shpresë se vetëm me kërkesa të bashkuara dhe të definuar në mënyrë të qartë, mund të bëhen ndryshime që do të përmirësonin kushtet e profesionit të gazetarit dhe të ruajnë standardet e profesionit.

Lidhur me këtë iniciativë të SHGM-së ka një koment i cili thotë: "Kjo iniciativë e SHGM-së që ka për qëllim të fokusohet tek gazetarët e rinj në shtet është për tu mbështetur fortë dhe për tu përshëndetur, kjo pasi që një ditë të rinjtë duhet të shndërrohen në gazetarë me përvojë të cilët ndoshta do të bëhen edhe redaktorë nëpër redaksi. Dua të theksoj se është tejet me rëndësi që në këtë strukturë, në postet udhëheqëse, të ketë gazetarë të rinj të cilët me propozimet e tyre dhe sugjerimet për përmirësim, modernizimin e vetë procesit të gazetarisë si profesion, do të kontribuojnë për avancimin e procesit dhe do ti japin një energji dhe inspirim të rinjve të cilët një ditë duan të bëhen gazetarë në mënyrë që të mos kenë hamendje, pasi që është një prej profesioneve më të bukura"







**Roli i organizatave të pavarura  
ndërkombëtare mediatike në  
krijimin e liderëve mediatik  
në Maqedoninë e Veriut**

---



## Roli i organizatave të pavarura ndërkombëtare mediatike në krijimin e liderëve mediatik në Maqedoninë e Veriut

---

### Standardet si një forcë transformuese nëpër redaksi

Gjatë periudhës së revolucionit teknologjik, ndodhi një rritje drastike e qarkullimit të informacionit. Gjërat u ndryshuan në mënyrë drastike nëse shikojmë vetëm nga pesë vitet e fundit. Rrjetet sociale e shndërruan secilin në të ashtuquajtur krijues të përmbajteve apo operues me informacione, ndërsa kontrolli për kualitetin dhe besueshmërinë e tyre thuajse nuk ekziston. Manipulimet digjitale më nuk janë një rrezik apo kërcënim, por një realitet i përhapur gjërësisht.

Prandaj është me rëndësi që gazetarët e rinj të mësojnë nga e ashtuquajtura shkollë e vjetër për etikë dhe standarde, ndërsa institucionet formale dhe joformale të ju mundësojnë të rinjve që ti paraqesin para botës storjes e tyre të formuara me integritet, efektivitet dhe gjithë-përfshirje. Vetëm gazetarë të trajnuar mirë dhe të motivuar shumë, mund ta luajnë rolin e rojtarëve të së vërtetës dhe të jenë sytë e vërtetë të qytetarëve në kohë kur shumica e qytetarëve janë apatik.

Në mënyrë që të ndodhin ndryshime masive nëpër redaksi, organizatat esnafe dhe organuzatat qeveritare e joqeveritare, duhet të japin më shumë përpjekje në krijimin dhe përgatitjen e një gjenerate të re të rojtarëve të demokracisë.

Paralelisht me këtë, një tjetër fenomen ka zënë një vend të rëndësishëm në jetën publike dhe e zhvlerëson dhe korrupton profesionin e gazetarisë. Gjatë dhjetë viteve të fundit, ndryshoi edhe gjuha me të cilën komunikojnë mediet. Diskursi publik është nxehur dukshëm, ndërsa gjuha vullgare është përhapur shumë. Jetojmë në një shoqëri ku pak njerëz kanë shumë, ndërsa shumica kanë pak. Ata që kanë para dhe fuqi, vazhdimisht kërkojnë vëmendje nga shumica duke përdorur retorika populiste, ndjelljen e frikës dhe pasigurinë e përgjithshme.

Në pesë vitet e fundit, opinioni publik ishte dëshmitar i luftërave speciale të personave të fuqishëm në politikë, forcat e sigurisë dhe biznesit, që mund ta destabilizojnë edhe shtete apo tërë apo rajone, dhe madje të nxisin edhe luftëra.

Është paradoksale, por edhe pse mediet tradicionale kanë më shumë fuqi njerëzore dhe financiare, rolin e zbulimit të temave të korrupsionit të lartë dhe keqpërdorimit të pushtetit, e kanë patur dy - tre redaksi të vogla që janë të specializuara për hulumtim. Raportimet e "PRIZMA", "360 gradë" dhe "(IRL) Laboratori i reporterëve hulumtues" dhe disa redaksi të tjera më të vogla të pavarura, kanë zbuluar shumë grabitqarë në luftën e informacioneve dhe të paktën pjesërisht kanë ndihmuar në zbulimin e narrativit të dëmshëm nga lufta speciale.

Kjo është për shkak të më shumë faktorëve, mes të cilëve vendin më kryesor e zënë ndikimet e biznesit dhe politikës ndaj bordeve redaktuese të medieve. Kjo vendosje e tillë nuk paraqet meritë dhe integritet, ndërsa atmosfera që e shpërblen përluljen e jo kualitetin dhe talentin, nuk ofron zhvillim personal dhe profesional. Kështu, nuk ekzistojnë aftësitë e nevojshme për prodhimin e përmbajtjes kualitative në shërbim të interesit publik.

Përmbajtjet e tilla thuajse nuk ka mundësi që të krijohen për shkak të gjithnjë e më shumë situatës së theksuar ku pronarët e medieve përzihen në politikën redaktuese të mediumit. Tek mediet kombëtare dominonin pronarët që mediumin nuk e kanë biznesin e tyre primar, por një mjet për arritjen e qëllimeve personale.

Kjo gjeneratë ka shijuar hapje më të madhe drejt botës falë proceseve politike të paqes në rajon gjatë viteve të 90-ta, pas një situatë të vazhdueshme luftërash. Pas vitit 2000 në territorin e Ballkanit Perëndimor, filluan të rrjedhin proceset e pajtimit dhe orientimit të përkushtuar drejt integritimeve evropiane, edhe pse jo në atmosferë dialogu, të paktën në atmosferë paqeje. Stabiliteti i përkohshëm në sferën e medieve rezultoi me investime nga ana e donatorëve ndërkombëtar që trajnuan gazetarët e rinj të Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të nxitet dialogu dhe bashkëpunimi në disa programe bashkëpunuese në Ballkanin Perëndimor.

Organizatrat të cilat do të ndikojnë më së shumti në rekrutimin e talenteve të reja dhe trajnimin e gazetarëve nga shtetet e Ballkanit, janë Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtues dhe Projekti për raportim të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

## Si krijonin inkubatorë talentësh redaksitë e viteve të 90-ta

Skena mediatike në fund të viteve të 90-ta ishte përplot me entuziazëm, ambicie dhe konkurrencë të pasur. Ishin hapur media të reja, dhjetëra autorë fantastikë krijuan publikime të pasura, ballina tejet emocionuese, kronika televizive të cilat mund të paraqiteshin edhe në CNN, dhe kishte një tentativë të përgjithshme për të bërë diçka më kualitative, më kreative dhe më të mirë.

Në atë kohë ishte shumë prestigjioze të jesh gazetar dhe për këtë redaktorët luanin rolin kyç.

"Nuk ekziston tekst që nuk mund të shkurtohet", kështu iu drejtoheshin disa prej redaktorëve gazetarëve të rinj, duke iu shpjeguar me shembuj ulur pranë tyre se ku dhe përse duhet të shkurtohet teksti i cili duhet të përmbajë vetëm 2500 karaktere. Prej atëherë, çdo "shkurtim i ardhshëm i tekstit" ishte një leksion i ri në gazetari. Këto këshilla të redaktorëve kanë pasur më shumë vlerë se sa mësimi në studimet universitare që në fakt ka qenë vetëm teori pa praktikë.

Gjatë viteve, kjo pasiguri është paraqitur si tejet inspiruese, kur redaktori ta lexojë tekstin, ndërsa gazetari ndërron mendim në momentin e fundit nëse fjalia që ka përdorur është tejet e gjatë, a ka përshkrim shumëgjyresh, mos ka shumë apo pak deklarata, a duhet ti japë tjetër përfundim?

Redaksitë në atë kohë kanë qenë inkubatorë të talenteve në gazetari por edhe udhë e trasuar për ta nën syrin e hapur të redaktorëve. Gazetarët e rinj pa përvojë ka ndodhur shpesh ta kenë tekstin për ballinën e gazetës apo kronikën kryesore në edicionin e lajmeve televizive. Pikërisht me këtë radhë dhe standarde janë rritur gjenerata të shumta të gazetarëve që edhe në ditët e sotme janë prezent në kanë role udhëheqëse në disa media.

Por, nëse dikur një redaksi ka mundur të krenohet me dhjetëra gazetarë të trajnuar në mënyrë profesionale, sot situata ka ndryshuar në mënyrë drastike. Selektimi negativ, avancimi i personave të dëgjueshëm në llogari të kualitetit, e ka bërë të veten. Redaktorët janë heshtur dhe janë larguar anash, prandaj edhe gjithnjë e më shumë po shtohen redaksitë që nuk kanë kolegjiime, dhe ajo çfarë është më e trishtë është se gjenerata të tëra të gazetarëve nuk e kanë shijuar fare procesin redaktues. Shumë prej medieve janë lëshuar në një konformitet politiko - ideologjik të pronarëve, dhe askush as që e mendon të kundërshtojë.

Sigurisht se nuk duhet të paraqitet fotografi rozë dhe të thuhet se atëherë nuk ka pasur ndikim politik apo të biznesit dhe presione, sigurisht që ka pasur, por ka pasur më shumë integritet dhe redaktorë të cilët nuk janë frikësuar dhe nuk janë hamendur të veprojnë në kundërshtim me atë që ju ka ardhur si kërkesë prej krerëve partiak apo pronarëve të mediumit.

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, pronarët e medieeve - duke mos i llogaritur vetëm pronarët e medieeve pasi ky term imponon distancë, ndërsa të tillë ka gjithnjë e më shumë - në tentativë për më shumë përfitim dhe në koordinim me elitat politike, e ri-definojnë rolin e tyre dhe në mënyrë të pamëshirshme dhe të hapur i përdorin mediet për arritjen e interesave biznesore dhe politike. Në këtë proces, fillimisht eliminohen të pabindurit kryesor, redaktorët, fshihen standardet profesionale, pushohen nga puna gazetarët të cilët nuk pranojnë të punojnë me direktiva nga shtabet partiake, ndërsa gazetarëve dhe redaktorëve të sapo angazhuar fakti që duhet ta huazojnë zërin dhe emrin në tekst të përgatitur paraprakisht u prezantohet si diçka normale dhe se këtu nuk ka asgjë të çuditshme.

Në këmbim, shumë prej këtyre të rinjve që nuk kishin as edhe një trajnim në kuadër të redaksive katapultoheshin me tekste që vendoseshin në ballinë apo bartnin kronikat kryesore televizive. Sigurisht që kjo ka ndikuar në cenim serioz të standardeve për të cilat në shumë media nuk kishte kush të luftojë pasi që pozitat e redaktorëve ishin të rezervuara për persona të dëgjueshëm apo propagandistë.

Elitat politike që ishin kumbarë të këtij procesi, këtë e shpërblyen me fonde qeveritare, ndërsa hapësirën e fituar e rregulluan me porositë më brutale politike, lajmet partiake dhe linçimin publik të personave që mendojnë ndryshe nëpërmjet komenteve.

Kjo mungesë serioze e një dore të fortë redaktoriale e cila jo vetëm që do ti mbrojtë standardet profesionale por edhe do të jetë udhëheqëse dhe faktor kryesor në arsimimin e gjeneratave të reja të gazetarëve në vitet e fundit, ka ndikuar në ndyrjen e imazhit të profesionit dhe përforcimin e perceptimit të publikut se gazetaria shërben për interesa të tjera në vend të të mirës së përgjithshme që është sinonim për termin e shumë përdorur - interes publik.

Në mënyrë shtesë, sot me dominimin e rrjeteve sociale dhe eksplodimin e portaleve-njeri, mediet maqedonase po bëjnë një luftë të pa kompromis për fitimin e publikut, luftë kjo në të cilën viktimat më e madhe janë standardet profesionale. Në garën për klikime, lajmet bëhet nga statuset në Facebook të personave anonim të cilat transmetohen pa verifikim, dhe kjo e bën të qartë situatën se tashmë opinioni nuk

mund të bëjë dallimin mes fakteve dhe pohimeve të pavërteta. Dhe derisa shumica nuk dëshirojnë ta pranojnë se gazetaria profesionale dhe gazetarët janë seriozisht të cenuar, profesioni veçmë po e paguan çmimin. Në studimet e dikurshme prestigjioze të gazetarisë ku paraqiteshin mbi 100 studentë, tani paraqiten dhjetëra. Në skenën mediatike në të cilën mbijetojnë numër tejet i lartë për kokë banori, përveç disa përjashtimeve të rralla, dominon një zhurmë e lajmeve të përsëritshme apo të kopjuara, spekulimeve, dezinformatave dhe propagandës politike.

Kjo gjendje nuk është e rastësishme, dhe ka për qëllim që ti ngulfasë çështjet e vërteta, ti mbulojë komentet e argumentuara dhe analizat e detajuara, të defokusojë prej temave të vërteta dhe çfarë është më me rëndësi, ta bind publikun se apatia është e arsyeshme. Për fat të mirë, shumica mund ta vërejnë këtë ende, por me këtë zhvillim të trendeve lokale dhe globale, gazetaria profesionale është e detyruar që të luftojë shumë më shumë për pozitën e saj, në vend se të fundoset në dekurajuese.

Lufta për kthimin e besimit nuk mund të rifitohet për një ditë, por është me rëndësi që të detektohet dhe të kemi qëllim ndaj tij. Kthimi i dinjitetit të profesionit nuk është i mundur pa një zbatim të pa kompromis të standardeve profesionale, integritetit dhe procesit të fortë redaktues, për çka duhet të zotohen edhe gazetarët, edhe pronarët, edhe redaktorët. Në të kundërtën, mediet profesionale më nuk do të mund të kthehen në fronin e sferës informative.

### **Përvoja e BIRN-it: mbrojtja e standardeve nëpërmjet aftësive për liderët e ardhshëm mediatik**

Rrjeti ballkanik i reporterëve hulmtues është organizatë që e kanë formuar pesë gazetares dhe një gazetar në vitin 2004, shumica prej tyre me përvojë të punës në media si "Reuters", "Financial Times", "BBC", "IWPR" dhe të tjera. Grupi i gazetarëve i ka bashkuar vlerat e përbashkëta dhe zotimet për një gazetar më ndryshe se sa ajo që shihet nëpër mediet "mainstream". Themeluesit vlerësojnë se formula e vërtetë është kombinim i standardeve botërore profesionale dhe dija lokale. Edhe përgjigja e pyetjes - e çfarë? Përse pikërisht kjo storje është e rëndësishme? Prandaj kanë vendosur që të formojnë një rrjet që do të kultivojë pikërisht këtë lloj të gazetarisë.

Pikërisht për këtë gjë publikimet e BIRN-it kanë një standard tejet të rreptë për përpunim të storjeve ku redaktorët e kanë rolin kryesor në secilën fazë, prej formulimit të tezës së punës, e deri tek faza finale e publikimit të storjes. Redaktori



e udhëheq dhe i jep direktiva gjatë gjithë procesit, prej hulumtimit preliminar, deri tek përzgjedhja e bashkëbiseduesve, përgatitja për intervista, kërkimet dhe interpretimet e dokumenteve dhe provave të tjera, deri tek struktura finale e storjes.

Ky proces nuk lejon kopjimin e verbër të statuseve nga rrjetet social e as nuk lejon përhapjen e pohimeve të paverifikuara nga qendrat partiake. Ky proces, jo rrallë kërkon shumë kohë, durim dhe nerva, dhe shpesh gazetarët në fazën preliminare studiojnë në mënyrë rrënjësore këndet para se të vendosin se cili do të jetë këndi i hulumtimit.

Gjatë punës me redaktorin, gazetari i mëson standardet por edhe kurthet që ndikojnë në saktësinë, precizitetin, verifikimin e informacioneve, se si trajtohen burimet, si zbulohen dhe përshkruhen burimet anonime dhe si verifikohen pohimet e tyre, dilemat etike, se si raportohet për zgjedhje në mënyrë të balancuar, si raportohet nga gjykata, si raportohet prej ngjarjeve tragjike, si shkruhet një sfond, si arrihet deri tek dokumentet, insistimi për përgjigje të atyre që janë të prekur nga tema, vlerësimi i situatës së rrezikut në disa raste.

Puna e gazetarit bartë shumë përgjegjësi dhe gazetarët për çdo ditë duhet të jenë të vetëdijshëm se si puna e tyre mund të ndikojë në jetët e njerëzve. Kjo sidomos kur jemi dëshmitar të raportimeve problematike dhe të pamenduara mirë kur nuk mbahet llogari për familjet e viktimave dhe shpejtohet me lajmërimin se dikush ka bërë vetëvrasje, apo kur nxiten tensione ndëretnike në tentativë për më shumë klikime dhe sensacionalizëm.

Gazetaria është forcë që nxitë lëvizjet sociale dhe politike dhe i zbulon krisjet e sistemit, dhe ndikon në vendimet që i sjellim në bazë ditore. Suksesi i gazetarisë në edukimin e opinionit mund ta afrojë apo ta largojë shoqërinë.

Lufta me lajmet e rrejshme, sidomos në kohë pandemie, na ka dëshmuar se doemos duhet të kemi gazetarë të trajnuar mirë të cilët do të jenë mbikëqyrës të paanshëm, dhe do të raportojnë me fakte, do të bëjnë vlerësime kritike dhe nuk do të stigmatizojnë.

## Aftësi, aftësi dhe vetëm aftësi

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, nëpërmjet trajnimeve nga programet e BIRN-it, kanë kaluar qindra gazetarë nga rajoni, shumica prej tyre tashmë janë redaktorë dhe gazetarë në media lidere, televizione, portale, në biografitë e të cilëve ka mirënjohje dhe shpërblime prestigjioze.

Bursa prestigjioze për ekselencë gazetareske, program me të cilin prej vitit 2007 në vit kyçen nga dhjetë gazetarë të rajonit dhe punojnë në analiza thelbësore dhe hulumtime, përfshin një trajnim të detajuar fillestar prej një jave, shumicën e kohës organizohen në Berlin dhe Vjenë. Para pandemisë kjo ka qenë një mbështetje e konsiderueshme financiare dhe redaktoriale për të përpunuar një storje prej disa muajsh. Shumica që kanë qenë pjesë e këtij programi thonë se nuk mund të zgjedhin vetëm një segment si më të mirin e programit. Shanset për udhëtim, njohja, shoqërimi, shkëmbimi i përvojave me kolegë të rajonit, por edhe vizita e redaksive të shteteve të tjera, kontaktet me gazetarë, por edhe krijimi i rrjetit të kontakteve në rajon dhe Evropë dhe miqësitë shumë vjeçare. Për shoqëritë në të cilat ka pak interes dhe më pak njohuri se çfarë ndodhë jashtë shtetit amë, ky lloj i programeve ofrojnë mundësi të shkëlqyeshme të mbindërtimit.

Pasi që gazetarët ta bëjnë versionin e parë të storjes, ata mbajnë sesione të detajuara disa herë në ditë me redaktorin që i udhëheq, shumicën e kohës redaktorë që kanë përvojë shumëvjeçare gazetareske dhe redaktoriale nëpër redaksi sikur ajo e "BBC", "Guardian", "Independent", "Politico" e të tjerë. Në këto sesione gazetarët mund të dëshmojnë nga dora e parë se si duket një proces në redaksitë e medieve të cilët kanë të varur në muret e tyre njohjet dhe çmimet më prestigjioze botërore, si ajo e Pulitzerit. Në disa momente të caktuara ky proces mund të jetë rraskapitës, madje edhe për gazetarë me përvojë disa vjeçare, kjo pasi që gjatë punës bëhet analizë e çdo fjale, por mundësohet një shembull i pa çmim se si vërtetë duhet të përgatitet një storje dhe përmban leksione gazetareske që nuk harrohen asnjëherë.

Shtytje shtesë janë edhe çmimet për tre storjet e para nga dhjetë gjithsej, dhe kjo bëhet çdo vit në një ceremoni përmbyllëse. Çmimet i ndajnë gazetarë të njohur dhe ekspertë nga Evropa dhe Ballkani.

Storjet e përpunuara publikohen edhe në anglisht por edhe në gjuhët e tjera të rajonit nëpërmjet medieve partnere të cila i publikojnë në të njëjtën kohë në disa shtete.

Prej vitit 2012<sup>11</sup>, BIRN organizon një shkollë verore për gazetari hulumtuese, një program një javor që mbahet në fund të gushtit në lokacione të ndryshme të Ballkanit ku pjesëmarrësit kanë mundësi që të dëgjojnë ligjërata dhe të trajnohen nga emra të mëdhenj të gazetarisë nga e gjithë bota. Programi i kësaj shkolle verore është dizajnuar në atë mënyrë që përfshin zhvillimin e aftësive dhe teknikave të reja, mjeteve hulumtuese, nëpërmjet ligjëratave dhe punëtorive me gazetarë të njohur nga mediet botërore si “New York Times”, “Reuters”, “Suddeutsche Zeitung (Zidojçe Cajtung)”, “Guardian”, “BBC”, “CBS” dhe të tjera.

Gazetarët që marrin pjesë në këtë shkollë kanë mundësi për të zgjedhur tema në të cilat do të punonin me kolegë nga rajoni, ndërsa BIRN mundëson edhe ndihmë financiare dhe ndihmë redaktoriale për përpunimin e storjeve rajonale<sup>12</sup> prej ekipeve të gazetarëve të cilat pasi që përpunohen publikohen në gjuhët e rajonit dhe në anglisht nëpërmjet publikimit të BIRN-it, Balkan Insight por edhe edicioneve të tjera prestigjioze.

Përveç këtyre programeve vjetore, BIRN organizon edhe trajnime të tjera për gazetarë për tema të ndryshme nga etika dhe standardet profesionale, trajnime për podkaste, për të drejta digjitale, për hulumtimin e krimit dhe korrupsionit, për hulumtimin e furnizimeve publike, rrjedhave të paligjshme financiare, kontrollin dhe verifikimin e fakteve, raportimin nga gjyqësori e të tjerë.

### Në hap me botën

Në kuadër të më shumë programeve të ndryshme, BIRN e trajnon gjeneratën e re të gazetarëve fillet e së cilës datojnë nga viti 2005, që nga marrja e statusit si shtet kandidat për anëtarësim të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Liberalizimi i vizave në vitin 2009 ishte momenti kyç për fillimin e trajnimit të atyre që duhej të bëheshin liderët e ardhshëm mediatik, të trajnura me standardet më të larta. Në atë periudhë trajnimet dhe shkollat e BIRN-it i kanë kaluar shumë gazetarë që ishin në fillet e karrierës, ndërsa tani janë gazetarë të pjekur.

---

11 Shkolla verore për gazetari hulumtuese e vitit 2012 BIRN, <https://balkaninsight.com/2012/05/25/birn-summer-school-2012-enrolment-2012/>

12 BIRN, Ndhimë financiare për përpunim të storjeve rajonale, <https://prizma.mk/godinata-niz-nasha-prizma/>

Katerina Topallova, gazetare dhe redaktore në Servisin Publik TVM1, punon për vite të tëra dhe ndjekë gazetarinë ditore.

“Ajo çfarë unë punoja ishte analizë, një përpunim i shkurtër ditor dhe prezantim i saj. Por, nëse vetëm pak thelloheni në secilën fjalë, do ndjeni mundësi për të dalë nga “korniza shtëpiake”, rrëfen ajo për përvojën e saj me Programin për ekselencë në gazetari nga BIRN.

“Mu hap horizonti kur e pashë se shanset ishin aty, para meje, se vetëm duhej ti shfrytëzoja. Momenti kyç ishte pjesëmarrja në shkollën verore në Rumani. Aty njoftova kolegë nga rajoni dhe kam dëgjuar përvoja dhe ligjërata prej redaktorëve që kanë punuar në media shumë prestigjioze botërore Kontaktet prej Brashov më hapën një mundësi të re, bursë për hulumtim gazetaresk. U paraqita dhe për një vit punova me redaktor i cili ka punuar në Servisin publik të Britanisë “BBC”. Telefonata të vazhdueshme, shkresa, takime sy më sy me këtë redaktor për të vetmen temë për të cilën isha duke punuar. Ky është një luks që redaktori në gazetarinë e përditshme nuk ta mundëson fare ose rrallë herë. Kam mësuar shumë, por posaçërisht e kisha me rëndësi mësimin e aftësive të reja dhe mënyrën e punës. Thujse në një kohë erdhi edhe mundësia edukim të mëtutjeshëm në fakultetin me renome për gazetari në Misuri të SHBA-së. Ky ishte një hap i rëndësishëm në karrierën time me të cilin me mënyrën e re të punës dhe përpunimit të kronikave të mia, kam marrë disa çmime për arritje në gazetari”

Nëse për një gazetar pasuria më e madhe janë kontaktet, atëherë këto dy përvoja për mua ishin urë që më ndihmuan të hyjë në ujëra më të thella”, thotë Katerina Topallova.

Kjo pjesë por edhe pjesa e ardhshme me arsye japin një njohje me organizatat që i zbatojnë praktikat dhe standardet më të larta dhe ku të rinjtë mund të plotësojnë veten, dhe më tej me punën e tyre do të japin kontribut lokal dhe global për ndryshime të rëndësishme politike të cilat do të kenë fuqi të ndryshojnë jetën e njerëzve për të mirë. BIRN është edhe ndër dritaret e para drejt botës për gazetarët të cilët më tej ndërtuan lidhje me organizata të rëndësishme botërore si Projekti Ndërkombëtar për Raportim për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin (OCCRP) i cili ndryshoi konceptin e medieve dhe i trasojë të njëjtit në shkallën e fuqisë, duke zbuluar afera si Danske Bank<sup>13</sup>, Panama Pejpers<sup>14</sup>, Landromati Rust<sup>15</sup> e të tjerë.

---


13 Shembull i cili ka të bëjë me Danske Bank i disponueshëm në <https://newsoncompliance.com/danske-bank-the-story-of-europes-biggest-money-laundering-scandal/>

14 Shembull i cili ka të bëjë me Panama Papers i disponueshëm në <https://www.bbc.com/news/world-35954224>

15 Shembull i cili ka të bëjë me Landromatin Rus, i disponueshëm në <https://www.occrp.org/en/landromat/the-russian-laundromat-exposed/>

Gazetarët e anketuar për qëllimet e këtij doracaku dhe situata momentale tek mediet të cilat ballafaqohen me akuza se nuk i shërbejnë të mirës së përgjithshme, tregojnë se gazetaria kualitative gjithnjë e më shumë ekziston jashtë mainstream-it por edhe se të rinjtë kanë interes për shumë më shumë se sa vetëm ndjekje të verbër të agjendave private. Sikurse në botë, ashtu edhe në shtet, gjeneratat e reja momenti determinues i të cilëve janë ngjarjet si kriza botërore ekonomike e vitit 2009 dhe ndryshimet klimatike, në fakt dëshirojnë që të kontribuojnë në mënyrë thelbësore tek mediet.

Pjesa e ardhshme e këtij publikimi do të tregojë se si gazetarët e rinj që e kanë kaluar trajnimin e OCCRP për ndjekjen e korrupsionit të lartë dhe krimin të organizuar trans atlantik, e që janë në vitet e para të karrierës, krijojnë hapësirë për forca të reja të cilat punojnë krah për krah me moshatarët e botës.



**Inkubatorë të rinj inovativ  
të talentëve:  
skenë e pavarur mediatike**

---



## Inkubatorë të rinj inovativ të talentëve: skenë e pavarur mediatike

---

### Nëpërmjet inovacioneve në qasje deri tek mediat me integritet

Sot gazetarët hyjnë nëpër mediet tërësisht të papërgatitur për punë praktike nga studimet universitare për të cilat mezi që ka ndonjë farë interesi. Pritjet janë që ato të mësojnë punën në redaksi. Por, në një kohë kur më me rëndësi janë rejtingjet ndërsa gazetaria është sensacionaliste dhe të gjithë luftojnë për vëmendje me çdo kusht, gazetarët nuk motivohen të punojnë në mënyrë më kualitative.

Kërkesa për informacione kualitative asnjëherë nuk ka patur më shumë potencial për të imponuar ndryshime. Për momentin, ekziston një pakënaqësi e dukshme dhe frustracione të përgjithshme për kualitetin dhe besueshmërinë e informacioneve. Mediet janë në nivelin historik të mos besimit, ndërsa modelet e tanishme biznesore nuk punojnë për të mundësuar shpërndarjen e informacioneve me interes publik.

Në kulturë prosperitare demokratike, mediet kanë përgjegjësi që të zotohen për zgjidhjen e çështjeve të bashkësisë, ndërsa për promovimin e këtyre përpjekjeve ka nevojë për media të lira, të forta dhe kritike. Mediet janë të polarizuara shumë – secili ka tendencë për ti interpretuar dhe analizuar informacione në bazë të përkatësisë së tyre – që rezultojnë me sigurimin e informacioneve të njëanshme apo të shtrembëruara për opinionin.

Modelet aktuale të biznesit që janë të bazuara në thithjen e reklamave apo mbështeten në të ardhura nga të dhënat e platformave sociale siç janë Google dhe Facebook, nuk e mbështesin idenë për shtyp të bazuar në integritet dhe shërbim të interesit publik.

Por, kjo punë për momentin është një prej gjërave më të dëshiruara shpesh të studentëve të Maqedonisë së Veriut. Kështu, në luftën për vëmendje të mediejeve kombëtare, të rinjtë i kanë marrë mediet – kopjuese dhe botimet senzacionalistike që kanë për funksion vetëm publikimin e gjërave që sjellin klikime, pasi klikimet sjellin më shumë para. Informacionet tani janë një biznes lukrativ i cili ka për qëllim të fillojë para prej tyre. E kjo bie ndesh me misionin kryesor të gazetarisë, ti shërbejë interesit publik, e jo përfitimit.



Në shkollën fillore dhe të mesme, Lila Karatasheva (22) ka mësuar vetëm se ka talent për të shkruar, e kjo falë detyrave praktike me shkrim në gjuhën maqedonase. Për dallim prej shteteve të zhvilluara të cilat investojnë në zhvillimin e aftësive për përpunim kritik dhe analitik të informacioneve dhe nxitjen e mendimit dhe prezantimit të ideve, në procesin arsimor të Maqedonisë së Veriut gjenerata e Lila Karatashevës nuk mund të shijojë programe të tilla dhe nuk kanë as privilegjin që gjatë shkollimit të tyre të mund të hapen media të gjimnazit dhe studentore.

“Gjatë studimeve jam ndjerë e gatshme për të punuar me gjysmë orari të punës pasi kështu do i rrisja të ardhurat mujore, por si person i ri kjo do të të linte hapësirë dhe kohë të lirë që të vazhdoj edhe me aktivitetet e mija vijuese. Fillova të punoj në një medium online. Detyra ime ishte që ti kopjoj dhe ti vendos video lajmeve të cilat buronin nga agregatori Time.mk dhe ti shpërndaj në Facebook me ndonjë përshkrim interesant në mënyrë që ti detyroj përdoruesit që ta klikojnë lajmin. E mbaj mend se në intervistën time të punës më është theksuar se unë nuk jam gazetar, duke marrë parasysh faktin se unë nuk kisha mbaruar fakultetin, dhe se jam vetëm krijuar përmbajtjes”

Për këtë punë nuk ka patur asnjë përgatitje, ndërsa thotë se secili qytetar mesatar me një arsim minimal, nuk ka nevojë për asnjë përgatitje.

“Prej kësaj pike, them se ajo ku punoja nuk ishte një medium. Momenti i trishtë i gazetarisë është se këtë vërtetë e bën secili dhe që puna e krijuesit të lajmeve paguhet më shumë se sa ajo e gazetarit. Vizioni im ishte shumë më i largët se sa të kopjoj lajme të huaja, prandaj ajo punë që bëja nuk më jepte aspak satisfaksion”, rrëfen Karatasheva dhe thotë se megjithatë këto përmbajtje ju sjellin përfitim pronarëve.

Gjatë vitit 2020, Karatasheva nisë punën si një vullnetare, praktikante, në një organizatë mediatike profesionale siç është Laboratori për gazetari huluntuuese (IRL), qendra lokale dhe partnere e Projektit për raportim të krimit dhe korrupsionit të organizuar (OCCRP).

“Mundi dhe lufta që e kam parë tek kolegët e mi të cilët me të gjitha forcat tentonin që ta zbulonin të vërtetën dhe të njëjtën ta shfaqin në disa faqe, më ka mahnitur tej mase që në javën e parë. Në IRL kam mësuar se gazetaria nuk është vetëm të shkruash por se për një produkt të mirë duhet shumë më shumë se sa vetëm talenti i një gazetari”, thotë ajo.

Lila Karatasheva trajnimin e saj të parë në një redaksi të vërtetë e ka bërë si një praktikantë e re në IRL, anëtare e Projektit ndërkombëtar për raportim të krimit dhe korrupsionit (OCCRP), edhe një organizatë tjetër që bëri ndikim të veçantë mbi kualitetin e raportimit nga sfera e sundimit të së drejtës në vendet e Ballkanit perëndimor, dhe përfshirjen e gazetarëve të rinj në proceset globale të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Nëse në vitin 2015 gazetarë të rinj nga Maqedonia e Veriut punonin për projektin Panama Papers apo rrjetëzimi dhe bashkëpunimi më i madh i gazetarëve në histori i cili ka vendosur themelet e gazetarisë moderne, sot të njëjtët gazetarë iu mundësojnë gazetarëve të rinj si Karatasheva që poashtu të punojnë në projekte të tilla. Këto janë elementet kyçe frymëdhënëse që i nxisin gazetarët që ti shërbejnë të mirës publike nëpërmjet vetëbesimit i cili vjen prej punës e cila është fryt i mundit, tranimit dhe aftësive të pranuar ndërkombëtarisht.

## **Përvoja e OCCRP**

Në Maqedoninë e Veriut redaktorët dhe gazetarët e rinj të cilët gjatë dekadës së fundit kanë punuar me OCCRP me fokus arritjen e aftësive analitike dhe kritike për zbulimin e krimit dhe korrupsionit, sot në një redaksi të vogël në Shkup, pa trajnime formale por vetëm me punë praktike dhe nxitje të gazetarisë së guximshme, po trajnojnë një gjeneratë të re të punonjësve mediatik të cilët do të japin kontribut në luftën botërore kundër krimit dhe korrupsionit, si një ndër kërcënimet më të mëdha të demokracisë.

Përvoja e tyre është prezantuar si një koncept unikat i cili i bashkon përvojat e redaktorëve dhe gazetarëve të rinj hulumtues, të cilët janë trajnuar dhe kanë punuar në tema rajonale dhe ndërkombëtare të cilat poashtu i kanë përpunuar edhe kolegët e tyre moshatarë nëpër Evropë dhe botë. Sot, nëpërmjet qendrës lokale IRL, ata trajnojnë forca të reja që janë në fazat e para të karrierës dhe që kanë ambicie për të krijuar standarde të larta dhe mendje kritike të cilat do ta kuptojnë fuqinë e medias dhe do ti vendosin standardet e ardhshme krahas me bashkëmoshatarët rreth botës.

Gjatë pesë dekadave të fundit, në mënyrë dramatike është theksuar globalizimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Me ndihmën e "Industrisë së shërbimeve kriminele" - bankave të korruptuara, kompanive të avokatëve, agjentëve për regjistrim e lobistëve, rrjetet kriminale gjithnjë e më shumë po i zhvillojnë tregjet e tyre ndërsa zyrtarët më të korruptuar dhe tajkunët e botës me shumë lehtësi po marrin, pastrojnë dhe zhdukin para të vjedhura. Rezultati është një transfertë e paparë pasurisë dhe një rrjet

global i korrupsionit të lartë dhe krimit që nxitë pabarazinë globale, ngritjen e grupeve ekstremiste dhe rënien e institucioneve demokratike nëpër të gjithë botën. OCCRP beson se ka nevojë për një rrjet për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Për ta arritur këtë gjë, ky rrjet është fokusuar në përforsimin e anëtarësisë që është prezente në afro 55 shtete dhe thuajse të gjithë kontinentet.

Me zhvillimin dhe pajisjen e rrjetit global të gazetarëve hulumtues dhe publikimin e storjeve të tyre, OCCRP po shfaq krimin dhe korrupsionin në mënyrë që opinioni të jetë i bindur se autorët do të mund të bartin përgjegjësi për veprimet. Si një platformë për gazetari hulumtues dhe rrjet global i medieve dhe gazetarëve të pavarur OCCRP po e zbulon përsëri gazetarinë si një të mirë të përgjithshme. Duke marrë parasysh rritjen e harxhimeve dhe kërcënimet në rritje për mediet e pavarura, OCCRP u mundëson medieve dhe gazetarëve burime kritike dhe mjete, duke përfshirë këtu edhe sigurinë digjitale dhe forenzike dhe atyre që punojnë në temat më të ndjeshme ju mundëson bashkëpunim me redaktorët më të besueshëm. Duke respektuar të gjitha standardet më të larta etike dhe ato redaktoriale të gazetarisë. OCCRP ka zhvilluar dhe ka shpërndarë mjete kulminuese teknologjike që të mundësojë bashkëpunimin dhe hulumtimin bazuar në prova dhe të dhëna. Është krijuar një platformë hulumtuese me të dhëna e njohur si Alef (Arkiva globale e materialeve hulumtuese për gazetari hulumtues)<sup>16</sup>, që mbështetet nga një softuer i krijuar dhe zhvilluar nga vetë organizata për tashmë dhjetë vite me radhë. Këtu gazetarët mund të kryqëzojnë më shumë se 1 miliard të dhëna dhe të gjejnë lidhjet dhe modelet kriminale dhe të bashkëpunojnë në mënyrë efikase edhe përtej kufijve.

“Shumica e gazetarëve nga Ballkani Perëndimor që për herë të parë punuan me OCCRP ishin gazetarë të rinj apo fillestarë dhe ato treguan mjaftë aftësi nëse me to punojnë redaktorë me përvojë. Nëse mund të trajnojmë të rinj që do ta ndihmojnë luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe që mund të kontribuojnë në pavarësimin e medieve në vendin e tyre, atëherë përse mos ta bëjmë këtë gjë më e herët e jo më vonë”, thotë Dru Salivan, themelues i OCCRP.

“Ne jemi këtu për të ndihmuar anëtarët tanë që të kenë qasje në teknologji të lartë dhe mbështetje njerëzore për punën e tyre, dhe investojmë në krijimin e yjeve të reja të hulumtimit”

Gjatë vitit 2018, me mbështetje të OCCRP, për shkak të pamundësisë për të udhëhequr dhe marrë pjesë në politikat redaktuese të medieve tradicionale, u formua Laboratori

---

16 OCCRP Aleph - The global archive of research material for investigative reporting, e disponueshme në <https://aleph.occrp.org/>

i reporterëve hulumtues. IRL për momentin është organizata e vetme e cila mundëson programe të posaçme për gazetarë të rinj që fokusohet në aftësi, guxim dhe integritet. IRL është pjesë e qendrave të OCCRP në Shkup. Themeluesit e saj punojnë me OCCRP tashmë një dekadë dhe në kuadër të punës së tyre ata kanë zbuluara shumë luftëra ndërkombëtare informative, spiunim, tregti me armë dhe korrupsion të lartë.

Në mënyrë shtesë, ekipi i IRL-së ka më shumë diversitet sa i përket profesioneve, dhe organizata tenton që të vendosë mekanizma të funksionimit të redaksive në kohën bashkëkohore që nënkupton më shumë aftësi, më shumë bashkëpunim dhe mënyrë më ndryshe të komunikimit me publikun. Në këtë drejtim ndërsa me shembullin e OCCRP, këtu nuk trajtohen vetëm gazetarë por edhe të rinj nga industritë kreative dhe industria IT të cilët kontribuojnë që storjet e rëndësishme të prekin deri tek një publik sa më i madh dhe të mundësojnë komunikim më të mirë. Nëpërmjet trajnimeve “purpose oriented” dhe mundësimin e qasjes deri tek trajnimet ekskluzive jashtë shteti, si dhe punës në tema nga korrupsioni i lartë që zakonisht në redaksitë tradicionale nuk u jepen gazetarëve të rinj, organizata tenton që ta bëjë gazetarinë atraktive për të rinjtë, ndërsa ata ti trajnojnë si individë të ardhshëm me integritet, guxim dhe aftësi për ndryshime.

Ekziston një mit i pranuar se temat e rëndësishme për qytetarët duhet ti trajtojnë ekskluzivisht gazetarët me përvojë. Është e vërtetë se të gjitha temat që trajtohen në redaksi duhet të jenë të një rëndësie të lartë, ndërsa të rinjtë duhet të marrin pjesë në fazat e kësaj pune në mënyrë që një ditë ti shërbejnë opinionit me përgjegjësi.

Në fillimin e trajnimit të tyre, gazetarët e rinj në IRL kalojnë tre faza kryesore. Këto faza përdoren për të vlerësuar edhe talentet e tyre specifike dhe aftësitë pikërisht gjatë ndeshjes me mënyrën e re të punës. Faza e parë është më e vështira dhe përfshin mësimin e teknikave të kërkimit dhe organizimit të storjeve hulumtuese. Gazetarët për një muaj duhet ti mësojnë bazat themelore të të dhënave në shtet dhe të paktën të rajonit siç janë kadastrat, regjistrat e kompanive, të dhënat e doganave, ueb faqet qeveritare, resurset e organizatave joqeveritare. Njëkohësisht në këtë fazë që zgjatë të paktën gjashtë muaj, gazetarët duhet të njohohen me resurset e OCCRP me qëllim që të shfrytëzohen dhe ti kenë në dispozicion kur ju duhen të dhëna apo servise së tjera, si për shembull forenzikë digjitale.

Gjithë kjo bëhet nëpërmjet punës dhe hulumtimeve aktuale të të rinjve të cilët e marrin rolin e hulumtuesve dhe asistentëve të redaktorëve dhe reporterëve.

### **Pajisja me aftësi analitike: infrastrukturë kritike për secilin medium**

Institucionet krijojnë baza tejet të mëdha të të dhënave publike dhe dokumente që në kohën e teknologjive të internetit dhe tentativat për një shoqëri të hapur po bëhen gjithnjë e më të kapshme. Njëkohësisht, këto të dhëna së bashku me punën në terren dhe aftësitë analitike po bëhen mjete kyçe për punën e gazetarëve hulumtues të shekullit 21.

Por, edhe përkundër gjoja hapjes së institucioneve e shprehur me gjenerimin e mijëra dokumenteve që vendosen online, mbetet sfiduese gjetja e tyre në grumbullin e madh të dokumenteve të ndryshme, pastaj selektimi i të parëndësishmëve prej atyre me rëndësi, dhe gjetja e mënyrës më të lehtë për arritjen deri tek të dhënat e vërteta që janë të nevojshme për gazetarët hulumtues që punojnë në sferën e antikorrupsionit dhe sundimit të së drejtës. Edhe një aspekt tjetër nga i cili përfiton gazetari është që vetë të dinë të ndjekin dhe kërkojnë të dhënat publike pasi kështu mungon agjenda e huaj që mund të dëmtojë procesin e zbardhjes së fakteve dhe gjetjen e së vërtetës. Gazetarët shpesh marrin dokumente edhe prej personave të tretë apo të ashtuquajtur burime. Por, edhe burimi më qëllim mirë ka ndonjë agjendë tjetër.

Aftësia që gazetarët vetë të kërkojnë dhe analizojnë të dhënat dhe nëpërmjet tyre të zbulojnë storje, e shkarkon të vërtetën nga agjendat e huaja dhe i bën pronarë të vetëm të storjes që duan ta transmetojnë.

**Krijimi i një infrastrukture  
kritike për secilin medium apo  
pajisja me aftësi analitike  
në tre faza**

---



# Krijimi i një infrastrukture kritike për secilin medium apo pajisja me aftësi analitike në tre faza

---

## Teknikat e kërkimit dhe mbledhjes së informacioneve

Faza e hulumtimit (research) fillon me ndërmarrjen e aktiviteteve për kërkim dhe mbledhjen e informacioneve.. Informacionet më tej organizohen dhe analizohen me qëllim që ti japin kontekst dhe kuptim më të thellë asaj që duam ta shkruajmë. Një pjesë tejet e rëndësishme e kësaj pjese është edhe mënyra se si do të prezantohen informacionet. Faktet, sidomos kur janë në një numër shumë të madh, mund të përzihen dhe bëhen konfuzë dhe kaotike. Prandaj gjatë prezantimit të tyre doemos duhet të formohet një narracion i qartë dhe i lexueshëm lehtë.

Qëllimi i hulumtimit është që të mblidhen të gjitha informacionet të cilat janë në drejtim të dëshmisë së hipotezës së hulumtimit gazetaresk. Kjo nënkupton mbledhjen e informacioneve për ngjarjet vijuese, lajmet, publikimet, raportet, rregullativat etj. Ndërsa më tej edhe kërkimi i informacioneve që lidhen me njerëz, kompani dhe mjete siç janë patundshmëritë, anije e aeroplanë që janë pjesë e hulumtimit.

Mekanizmi themelor për mbledhjen e informacioneve gjithmonë përfshin kërkimin në internet apo kërkimin fizik nëpër arkiva, institucione, biblioteka e të tjerë. Megjithatë, me zhvillimin teknologjik dhe procesin e digjitalizimit, shumica e informacioneve janë të kapshme online, kështu shumica e hulumtimit gazetaresk bazohet në kërkimin online – nëpërmjet burimeve të qasshme publike apo nëpërmjet data – bazave komerciale të të dhënave.

## Kërkimi i informacioneve të qasshme publike online

Kërkimi i informacioneve publike të qasshme online është hapi i parë dhe nënkupton mbledhjen e informacioneve nga burime të cilat janë të kapshme dhe deri tek të cilat mund të arrijë secili. Nëpërmjet këtij kërkimi, mund të arrihet deri tek çdo lloj informacioni pavarësisht nëse po kërkohen lajme aktuale, informacione për kompani, persona apo mjete.



Mjetet më të përdorura për kërkim të informacioneve janë softuerët për kërkim në ueb si "Google", "Bing", "DuckDuckGo", "Yandex" dhe të tjerë. Secili prej këtyre kërkuesve e ka të njëjtin funksion, mënyrë sistematike e kërkimit të informacioneve duke shtypur tekstualisht kërkesën. Por edhe secili prej kërkuesve ka mundësitë e ndryshme të kërkimit si:

- » Kërkim i avancuar
- » Kërkim me fotografi
- » Vlerësim i besueshmërisë së burimit të informacionit

### **Kërkimi i kompanive dhe personave**

Burimi i vetëm zyrtar për kërkim të kompanive që mund të përdoret si provë në hulumtimin gazetaresk është regjistri zyrtar dhe informacionet e marra prej aty. Të gjitha informacionet e tjera të mbledhura nga burimet e qasshme publike si për shembull "OpenCorporates"<sup>17</sup>, apo data bazat e tjera komerciale, nuk mund të përdoren si informacione zyrtare.

Shumica e shteteve lejojnë kërkimin e regjistrave të kompanive nëpërmjet internetit, apo qasjen e tërësishme në informacionet dhe dokumentet e një kompanie. Por në shumë raste këto baza të të dhënave në internet mund të kërkohen vetëm me emrin apo numrin e identifikimit të kompanisë dhe nuk mundësojnë kërkim me emrin e pronarit.

Për shkak të kufizimeve që vijnë prej kërkimit individual të kompanive në regjistrat e secilit shtete veç e veç, ekzistojnë baza komerciale të të dhënave. Këto baza japin mundësi të pafund kur bëhet fjalë për kërkim të kompanive dhe njerëzve. Ata mundësojnë kërkimin në bazë të fjalëve kyçe që kërkojnë në një numër të madh bazash të cilat mund të zbulojnë rrjet të kompanive nëpër të gjithë botën.

Kur kërkohet emri i një personi, gjëja më me rëndësi është që mos heqni dorë nëse nuk e gjeni menjëherë emrin e kompanisë. Hulumtuesit gjithmonë duhet të provojnë të bëjnë kërkimin me mbiemër apo me variacione të kërkimit dhe me drejtshkrim. Në mënyrë që të shmangin identifikim, njerëzit shpesh përdorin emër, përdorin mbiemër apo mbiemër të vajzërisë, apo shpikin emër të ri. Regjistrat për aktivitetet biznesore ndonjëherë duken edhe në mënyrë tjetër.

---

17 OpenCorporates - The largest open database of companies in the world, e disponueshme në <https://opencorporates.com/>

Është e nevojshme që hulumtuesit të tentojnë të kërkojnë me adresa, edhe adresa të personave edhe të kompanive. Mund të gjenden më shumë kompani të regjistruara në një adresë. Një numër i madh kompanish të lidhura me familjen e presidentit të Azerbejxhanit Ilham Aliev ishin gjetur si të regjistruar në një vend – adresa e banimit të vetë familjes..

Në mënyrë që ta mbulojnë identitetin e vërtetë të pronarëve, shpesh përdorin edhe person të autorizuar – person që vepron në emër të dikujt tjetër. Mund të bëhet fjalë për familjar të afërt, bashkëshort apo fëmojë, por edhe partner biznesi, mik, avokat i besueshëm apo një identitet të huazuar.

### **Mbledhja e informacioneve offline**

Kjo fazë zgjatë tre muaj. Gjatë këtyre tre muajve, secili gazetar i ri i cili është pjesë e programit për trajnim në IRL, tashmë di si të përdorë Ligjin për qasje deri tek informacionet me karakter publik<sup>18</sup> dhe si ti gjejë informacionet që janë të qasshme në formë elektronike.

Ekzistojnë të dhëna që janë të klasifikuara dhe për të cilat vërtetë nuk ka asnjë bazë që të jenë të tilla, sidomos kur bëhet fjalë për përgjigje të ndjeshme nga sfera e sigurisë. Problemi që paraqitet është kur institucionet duan të fshehin të dhëna që në fakt janë publike, me qëllim që të mbrojnë funksionarët nga lidhja apo përgjegjësia penale, prandaj shpesh zgjedhin që të mos i japin të dhënat duke u arsyetuar se ato janë të klasifikuara.

Në këtë pjesë shkurtimisht do të shpjegohet se si e drejta që buron nga Ligji për qasje të lirë deri tek informacionet mund të jetë një mjet i shkëlqyeshëm për hulumtimet gazetareske. Ky ligj i rregullon dy çështje: të dhënat që institucionet duhet ti publikojnë në ueb faqet e tyre dhe të dhënat që qytetarët mund ti kërkojnë prej institucioneve shtetërore dhe publike nëpërmjet formularëve për kërkesë për informacione.

Ligji për qasje të lirë deri tek informacionet iu mundëson qytetarëve të kërkojnë çfarëdo lloj informacioni me shkrim që lidhet me punën e institucioneve si dhe të gjitha informacionet për institucionet që bëjnë pjesë në informacionet me karakter publik.

---

18 Ligji për qasje të lire deri tek informacionet, 16.05 viti 2019, <http://www.mod.gov.mk/wp-content/uploads/2019/07/Zakon-za-sloboden-pristap-do-informacii-od-javen-karakter.pdf>

## Si të arrijmë deri tek informacionet që nuk janë në internet

### Procedura për lëshimin e kërkesës për qasje deri tek informacionet

Kërkesa mund të dorëzohet personalisht, nëpërmjet postës apo në mënyrë elektronike, nëpërmjet emailit. Nëse hulumtuesi e bën kërkesën personalisht, apo me gojë, atëherë kjo duhet bërë personalisht në hapësirat e institucionit, personi që është përgjegjës për qasje deri tek informacionet është i detyruar që ta ndihmojë qytetarin që ta bëjë kërkesën me shkrim nëse ka nevojë. Nëse informacioni kërkohet në këtë mënyrë, sipas ligjit, institucioni është i detyruar që ti përgjigjet në afat prej tre ditësh pune.

Mundësia e dytë është që të dhënat të kërkohen me shkrim, nëpërmjet postës. Ndërsa opsioni i tretë është që të dhënat të kërkohen në mënyrë elektronike. Shumë prej institucioneve nuk janë të njoftuar mirë me ligjin, prandaj edhe ka gjasa që të mos e pranojnë kërkesën e dërguar në mënyrë elektronike. Shpesh ndihmon nëse e theksoni në kërkesën tuaj arsyen përse keni bërë kërkesën për informacion në këtë mënyrë.

Shembull më poshtë:

Kur kërkesat bëheshin në mënyrë elektronike, në NOVATV kjo zbatohet në mënyrë të obligueshme, dhe atëherë zyrtarët shumë rrallë guxonin që tu kërkojnë gazetarëve që ti bëni kërkesën nëpërmjet postës së thjeshtë.

*I/e nderuar (emri i personit përgjegjës)*

*Si person zyrtar për informacione me karakter publik, në pajtueshmëri me publikimet e Komisionit për qasje të lirë deri tek informacionet, ju dërgoj kërkesat e mia për qasje të lirë në mënyrë elektronike sipas mundësive ligjore*

*Mësim:*

*Neni 12 (1) Parashtruesi i kërkesës për qasje deri tek informacioni mund ta bëjë në mënyrë gojore, me shkrim, apo nëpërmjet shkresës elektronike. (2) Secili parashtrues i kërkesës ka të drejtë të kërkojë prej poseduesit të informacionit që të ketë qasje deri tek informacioni në formë direkte, me shkresë, fotokopje apo shkresë elektronike.*

## Si t'i gjeni poseduesit e informatave

Në ueb faqen e Komisionit për mbrojtje të së drejtës për informata me karakter publik, në menynë më së larti ka seksion të quajtur "Lista e poseduesve të informacioneve"<sup>19</sup>. Kur të klikoni në listë mund ta selektoni institucionin që ju duhet dhe aty do të gjeni kontakt informacione nga personi përgjegjës për qasje deri tek informatat me karakter publik të institucionit, adresën dhe email adresën.

## Ku ta gjeni formularin për kërkesë për informata me karakter publik

Në ueb faqen e Komisionit për mbrojtje të së drejtës për informacione nga interesi publik, në banerin e djathtë vertikal ka një pjesë ku shkruan "Formulare". Klikohet tek ai baner dhe ai pastaj të çon deri tek një faqe tjetër prej ku mund të shkarkoni formularet<sup>20</sup>.

## Si të pyesni?

Kyçe është që të dihet të kërkohet informacioni në mënyrë të drejtë. Ligji i Maqedonisë parashikon se duke u shërbyer me të drejtën për qasje të lirë deri tek informatat, mund të kërkohet secili informacion që është krijuar në mënyrë të shkruar.

Çfarë do të thotë kjo dhe çfarë gabime bëjnë gazetarët?

## Asnjë pyetje nuk fillon me sa, si dhe përse?

Për të kuptuar më mirë se për çfarë bëhet fjalë dhe çfarë do të thotë informacion i krijuar në mënyrë të shkruar shikoni shembullin më poshtë.

---

19 Lista e poseduesve të informacioneve me karakter publik e disponueshme në - <http://komspi.mk/%d0%bb%d0%b8%d1%81%d1%82%d0%b0-%d0%bd%d0%b0-%d0%b8%d0%bc%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%bb%d0%b8-%d0%bd%d0%b0-%d0%b8%d0%bd%d1%84%d0%be%d1%80%d0%bc%d0%b0%d1%86%d0%b8%d0%b8/>

20 Formularet janë të disponueshme në - <h://komspi.mk/%d0%be%d0%b1%d1%80%d0%b0%d1%81%d1%86%d0%b8/>

“Në vitin 2011 derisa ende isha gazetare e re dhe nuk isha shumë e informuar për mënyrën e se si shfrytëzohet kjo e drejtë, kam parashtruar kërkesë për qasje deri tek informacionet me karakter publik deri tek kabineti i ish kryeministrit, ndërsa pyetja ishte:

*Sa para ka harxhuar kryeministri Nikolla Gruevski në vitin 2008, 2009 dhe 2010 për rod-shout në të cilët kërkonte investitorë?*

Përgjigjen që e morëm thotë kështu:

*Qeveria e RM-së nuk e posedon këtë informacion.*

Dhe ja si pyetjen e njëjtë e kemi parashtruar në korrik të vitit 2016:

Poseduesit të informacionit ia kërkoj informacionin me karakter publik si vijon:

Vendime për udhëtim zyrtar, vërtetime për rrugë, përlogaritje për mëditje zyrtare, faktura prej hoteleve dhe biletave të avionit, llogari fiskale nga shërbimet e hotelerisë, raport nga kartela zyrtare e kryeministrit dhe anëtarëve të kabinetit për të gjithë udhëtimet zyrtare të viteve 2011, 2012, 2013, 2014, 2015.

Përgjigja që e morëm ishte se ky informacion është i klasifikuar si intern dhe se publikimi i këtij informacioni mund të shkaktojë pasoja eventuale të dëmshme ndaj shtetit dhe qytetarëve dhe kjo është më e fortë se sa interesi publik. Edhe pse kjo përgjigje është absurde, në shembullin e dytë për përfitim që mund ta kenë gazetarët me kërkesa do të shihet se këtu kësaj radhe Qeveria nuk thotë se nuk e posedon informacionin.

Përse? Për shkak se institucionet mund të ju japin vetëm informacione që janë krijuar, dokumente që ekzistojnë. Nëse Qeveria apo cilido institucion nuk ka krijuar dokument në të cilin thuhet se kanë harxhuar mjete të caktuara financiare gjatë vitit të udhëtimit, atëherë ky informacion nuk është krijuar. Udhëtimet zyrtare paguhet sipas ligjeve të shteti dhe për to mbahet evidencë kontabiliteti. Domethënë, mund të kërkojnë vetëm dokumente.

## Si ta dimë se cili dokument e përmban atë që na nevojitet

Për shembullin më lartë janë konsultuar kontabilistë dhe i pyetëm se si i trajtojnë udhëtimet zyrtare dhe ato na shpjeguan se çfarë duhet të kërkojmë. “Gjithmonë mendoni se kush mund ta dijë se ku fshihet informacioni”.

Me rëndësi është që të shqyrtohen ligjet. Ishte drejtuar një pyetje deri tek Drejtoria për zonat industriale zhvillimore, se sa para ju jep shteti në emër të subvencioneve dhe cilat janë lehtësimet që i kanë investitorët e huaj, kjo me qëllim që të hulumtohen beneficionet.

Tashmë është e konstatuar se nuk mundet të shkruhet në formular thjeshtë se “sa na kushtojnë investimet e huaja”. Kur nuk ekziston opsioni “thirre mikun” si kontabilistin, hapini të gjitha ligjet që i rregullojnë këto investime dhe aty kërkonte se si dhe në çfarë dokumentesh janë të rregulluara këto benefite pasi që secili ligj e rregullon këtë gjë.

Ligjet zbulojnë se ka më shumë institucione të cilat e rregullojnë punën e zonave industriale si Agjencia për investime të huaja, Ministria e ekonomisë, por një institucion ka kompetenca të rregulluara me ligj që ti mledhë këto informacione – Drejtoria për zonat zhvillimore industriale. Kështu atyre u është kërkuar kjo:

*Marrëveshje për qira dhe nënqira ndërmjet themeluesit dhe përdoruesit e TIRZ3 për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014*

*Vendime për fillimin me punë të shfrytëzuesve të TIRZ3 për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014*

*Akte për lirim nga tatimi dhe lehtësime të lëshuara nga shfrytëzuesit e TIRZ3 për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014*

*Marrëveshje për ndarje të ndihmës shtetërore për investime fillestare produktive me të gjithë përdoruesit për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014*

*Raporte vjetore nga themeluesit e TIRZ3 për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014*

Ligjet gjithnjë janë një burim i mirë nëse dëshironi të vërtetoni se çfarë konkretisht duhet të kërkohet. Të gjithë gazetarët inkurajohen që të konsultojnë edhe organizatat joqeveritare të cilat punojnë shpesh në këtë fushë (për to në GetData në seksionin

Pyetni Ekspertin)<sup>21</sup> pasi ato mund të ndihmojnë shumë kur kërkohen këto të dhëna. Poashtu, të punësuarit në shërbimet e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë deri tek informatat me karakter publik mund të ndihmojnë për plotësimin e kërkesës. Në shumicën e rasteve të punësuarit gjithmonë kanë dalë në ndihmë, prandaj nuk duhet përjashtuar kontakti në telefon me to apo të shkohet direkt në komision dhe të kërkohet ndihmë.

### Si të parashtroni pyetje deri tek Bashkimi Evropian

Mjeti “Ask the EU” apo “Pyete Evropën”<sup>22</sup> të cilin e ka krijuar organizata ndërkombëtare me seli në Spanjë “Access Info Europe”<sup>23</sup>, është një prej mjeteve më të thjeshta, më efikase dhe më të famshme për gazetarët gjithandej Evropës kur bëhet fjalë për parashtrimin e kërkesës për qasje deri tek informacionet për institucionet e Bashkimit Evropian.

Ky mjet funksionon në mënyrë shumë të thjeshtë – në mënyrë direkte, në ueb faqen e tyre, kanë një seksion ku mund të dorëzohet kërkesa. Shkruhet në formën e tyre (në anglisht apo në gjuhën e ndonjë prej shteteve anëtare), zgjidhet institucioni deri ku duhet të dërgohet kërkesa, dhe ata kanë afat prej 15 ditësh pune për të dhënë përgjigje.

Pyetja por edhe përgjigja e dhënë, do të vendosën publikisht në ueb faqe dhe të gjithë do të mund ti lexojnë. Mund të ndiqen edhe kërkesa të tjera që janë dorëzuar nga subjekte të tjera që janë lëndë interesi.

Shembull i shkëlqyeshëm për atë që është shkruar më lartë mund të shihni në linkun në vazhdim<sup>24</sup>, afër storjes së NOVATV e cila u krijua falë pyetjes me karakter publik që ju drejtua këtij servisi.

### Organizimi i hulumtimit

Në fund të vitit të parë të pjesëmarrjes në trajnimin e IRL-së secili gazetar i ri di të kërkojë dokumente dhe persona brenda shtetit por edhe jashtë tij dhe di si të raportojë në terren dhe të organizojë në mënyrë të mëvetësishme hulumtimin.

21 GetData është mjet për studentët e gazetarisë, gazetarët, sektorin civil i cili punon me hulumtime që lidhen me korrupsionin dhe sundimin e së - <http://www.getdata.mk/>

22 E disponueshme në - [https://www.asktheeu.org/en/select\\_authority](https://www.asktheeu.org/en/select_authority)

23 E disponueshme në - <https://www.access-info.org/>

24 E disponueshme në - <https://novatv.mk/file-gi-chuva-tajnite-pisma-na-gruevski/>

Në IRL secili hulumtim vendoset në një folder i cili ka rrjet të mbrojtjes së sigurisë ndërsa secili gazetar doemos posedon edhe rrjet VPN. Hulumtimet më të mëdha organizohen në mënyrë që doemos krijohen nën folderë dhe dokumente me përmbajtjen e ardhshme:

1. Krijimin e një kornize kohore (që e jep fotografinë e madhe për të gjithë ngjarjet e lodhura në mënyrë direkte apo indirekte me qëllimin e hulumtimit)
2. Krijimi i një liste me persona të interesit
3. Krijimin e një liste me kompani të interesit
4. Lista e teorive
5. Ndarja e viktimave
6. Ndarja e burimeve njerëzore
7. Lista e kontakteve
8. Profilimi i burimeve
9. Poseduesit e informacioneve
10. Planifikimit i resurseve

Gjithnjë e më shumë gazetarët e rinj marrin edhe një redaktor më të ri në radhët e tyre. Në IRL ekziston një praktikë që gjatë trajnimit të emërohet një redaktor më i ri. Ai është përgjegjës që pasi të ketë dokumentuar folderin e sipërm të argumentojë para redaktorit hipotezat e ekipit dhe të japë përgjigje në çështjet në vazhdim:

1. Cilat janë viktimat tona
2. Cilët janë heronjtë tanë
3. Cili është plani jonë i sigurisë
4. Cila është storja jonë minimale e cila maksimale

Teknikat e dhe teknologjitë e shkruara më lartë janë vetëm një pjesë e serive të aftësive dhe teknologjive në dispozicion për të krijuar një punë kualitative e cila do të ketë më shumë ndikim. Prej pyetësorit i cili ishte zbatuar mes një grupi më të madh të gazetarëve të rinj nëpërmjet të cilëve po bëhet tentativë për tu mësuar nevojat e të rinjve në sektorin mediatik, është e dukshme se gazetarët duan të arrijnë aftësi të reja, por ekziston shumë pak apo aspak interes në redaksi që të ju mundësohet një gjë e tillë. Një pjesë e aftësive të cilat të rinjtë në këto qendra për hulumtim i kanë fituar janë aftësi konkurruese për secilën grup moshë. Kjo na çon deri tek përfundimi se problemi themelor janë metodat e vjetra të mësimi, angazhimi jo i mjaftueshëm i redaktorëve me kolegët më të rinj, mungesa e e politikave institucionale mediatike për krijimin e kuadrit të ri.







# **Konkluzë dhe mesazhe me integritet**

---



## Konkluzat dhe mesazhet me integritet

---

Roli i gazetarëve të rinj në industrinë mediatike është tejet me rëndësi, prandaj edhe mediet duhet të krijojnë mekanizma për tërheqjen por edhe motivimin e kuadrove të reja për punë. Edukimi në vendin e punës por edhe mundësia që mediet të ofrojnë mundësi që gazetarët e rinj të marrin pjesë në trajnime të jashtme të organizuara nga organizatat mediatike, është tejet me rëndësi për zhvillimin profesional të punonjësve të ri mediatik.

Në kushte kur profesioni i gazetarisë ballafaqohet me mungesë të kuadrove të reja, është e nevojshme që menaxhmenti i medieve të mendojë si ti nxisë gazetarët e rinj profesional që të vazhdojnë të jenë aktivë në mediet e tyre. Përveç kësaj, redaksitë e mëdha duhet të kenë mekanizma të brendshëm për edukim të kuadrove të reja në mënyrë që ti mbrojnë nga gabimet e paqëllimta gjatë krijimit të përmbajtjeve gazetareske jo vetëm ata por edhe publikun. Statusi social dhe standardi mbetet një sfidë në sektorin mediatik në nivel global, por, kjo nuk guxon që të ndikojë për nënvlerësimin e gazetarëve të rinj dhe mundit të tyre. Shoqatat dhe organizatat esnafe duhet të kyçin në programet e tyre vjetore dhe planet strategjike edhe kyçjen e gazetarëve të rinj në aktivitete të ndryshme nëpërmjet të cilave do të nxitet zhvillimi i kapaciteteve të tyre. Po ashtu, këto organizata dhe media duhet të mendojnë për partneritet me institucionet e larta arsimore në mënyrë që të ju ndihmojnë studentëve të gazetarisë të kenë më shumë përfitim nga puna praktika në tema që lidhen me punë hulumtuese, etikë në gazetari, trende të reja të gazetarisë e ngjashëm.

Përveç kësaj, institucionet e larta arsimore duhet ti ndjekin trendet moderne të profesionit dhe në këtë mënyrë të kenë kurrikula atraktive të cilat përsëri do të tërheqin numër të lartë të studentëve të gazetarisë.

Bartësit e funksioneve publike, politikanët dhe personat e kompanitë e tjera me përgjegjësi shoqërore, duhet që gjatë paraqitjeve të tyre publike ti inkurajojnë gazetarët e rinj kritik që të vazhdojnë të jenë profesional pasi që ka nevojë për të rinj që promovojnë dhe mbrojnë interesin publik.

Në këtë drejtim, katër punonjës të ri mediatik që janë kyçur në këtë publikim me esetë e tyre personale, dërgojnë mesazhe për ndryshime, por ajo që është më e rëndësishme janë mesazhet e tyre për motivim të të rinjve që të kyçen në punën e opinionit dhe të kontribuojnë për ndryshime.

Gazetarët e rinj nuk duhet të vlerësohen si “vrापues” që presin thërime apo plotësojnë urdhra vetëm që ti fitojnë pesë minutat e tyre. Të rinjtë në shtet duan të mësojnë, të shpërblehen dhe të gjejnë kuptim dhe ardhmëri në profesionet që do të vendosin ti realizojnë. Me gjeneratë me ambicie të tilla, janë të mundshme ndryshime rrënjësore tek mediet dhe shoqëria në këtë kohë jetese.

### LILA KARATASHEVA, gazetare (22)



Dëshira për gazetari u paraqit nga nevoja për të shkruar dhe nga loja, loja e redaksisë. I vendosja vetes rregulla se për sa mund të shkruaj një tekst. Doza e vetëbesimit që e ndjeja në atë kohë e kisha marrë nga shkolla. Isha tejet e lumtur kur në orët e gjuhës maqedonase kishim detyra që të shkruajmë ese apo fjalë lavdëruese. Ndjehesha shumë krenare kur mësuesit kishin vetëm lëvdata për mua. Ndërsa dëshira që një ditë të shkruaj tema për problematika më të mëdha dhe kjo të lexohet para një publiku më të madh se sa klasa ime, ishte më e fortë se gjithçka.

Shkrimet e mija vazhduan të jenë shembull për punë të mirë edhe në shkollën e mesme, por nevoja për informim më të gjerë mediatik tek unë u shua. Kjo ishte periudha kur mediet e “fuqisë së shtatë” filluan të shndërrohen në dëgjues partiak ndërsa unë asnjëherë nuk kisha afinitete të tilla. Nuk isha mjaftueshëm e rritur por isha mjaftueshëm e vetëdijshme për realitetin e errët i cili po ndodhte në mesin tonë derisa nga ana tjetër e televizionit gjithnjë shfaqej një fotografi rozë për shoqërinë tonë.

Gjatë studimeve ndjehesha e gatshme që të punoj me gjysmë orar pasi kështu do ti rrisja të ardhurat e mija mujore, por si person i ri kjo do të më linte edhe kohë shtesë për të vazhduar me akvitetet e mija vijuese.

Fillova të punoj në një medium online. Prej kësaj pike të këndvështrimit, atë nuk do e quaja medium. Për fat të keq jetojmë në një kohë ku ka mungesë të produkteve gazetareske që janë të zëvendësuara me lajme të cilat në disa momente dinë edhe ta ofendojnë inteligjencën njerëzore por edhe sjellin klikime dhe fitim të shpejtë për pronarët e portaleve.

Detyra ime ishte që të kopjoj dhe tu vendos video lajmeve të cilat fillimisht dilnin në agregatorin e lajmeve Time.mk dhe ti shpërndaj në Facebook me ndonjë përshkrim interesnt i cili do ti shtynte përdoruesit që ta hapin lajmin. Mbaj mend që gjatë intervistës së punës ma patën theksuar se unë nuk jam gazetar pasi kjo gjë është diskutabile sepse nuk e kam të mbaruar fakultetin, dhe se jam një “krijues përmbajtjesh”.

Për këtë punë nuk kisha asnjë përgatitje, mendoj që është diçka që secili do të dinte ta bëjë mirë. Momenti i trishtë i gazetarisë është se vërtetë këtë gjë e bën secili dhe se “krijues përmbajtjesh” është punë që paguhet më shumë se sa puna e gazetarit. Vizioni im ishte shumë më i madh se sa vetëm të kopjoj lajme të huaja pasi kjo punë mua nuk më sillte asnjë satisfaksion. Edhe pse gazetaria është një punë me rrezik e cila kërkon shumë ndërsa nuk sjellë shumë përfitim, vendosa të filloj. Jam e kënaqur që takimi im i parë me gazetarinë ishte IRL. Ndjenja se vërtetë ekziston informim i vërtetë dhe objektiv i qytetarëve ma ktheu dëshirën e shuar për gazetari. Lufta dhe munda që e vëreja tek kolegët të cilët me të gjitha forcat tentonin ta hulumtonin të vërtetën dhe ta shfaqin në disa faqe, më ka mahnitur që nga java e parë. Vlerësoj se gazetarët e rinj të cilët janë pjesë e IRL-së kanë vërtet fat që në asnjë moment nuk janë të degraduar për shkak të moshës se mungesës së përvojës. Nga momenti i parë kemi punuar paralelisht me kolegët më me përvojë dhe gjatë ndihmës së tyre në proces kemi ndihmuar të krijojmë storjet vetë. Në IRL kemi mësuar se gazetaria nuk është vetëm shkrim por hulumtim. Hulumtimi është pjesa më e madhe dhe më sfiduese e punës, pjesa që merr më shumë kohë, por gazetarëve iu mundëson më shumë siguri dhe vërtetësi në informacionet të cilat plasohen. Nuk ka shkrim të mirë pa hulumtim të mirë.

Ditën kur në ueb faqen e IRL-së u publikua hulumtimi im i parë i mëvetësishëm kam marrë ofertë që të kthehem të punoj në medium online për një pagë më të madhe nga ajo që tashmë e marr. U dëshpërova jo vetëm se kisha hamendje a të pranoj apo jo, por më dëshpëronte mendimi që portalet online kanë për të ofruar më shumë para për krijimin e një produkti jo kualitativ katër minutësh.

Nuk dua të jem modeste e rrejshme dhe të them se financat nuk janë me rëndësi, përkundrazi.

Por, i lejova vetes që të udhëhiqem nga mendimi se nëse duam ta ndryshojmë botën, duhet të fillojmë prej vetes.

Në IRL jam gazetar ende pa e marrë diplomën në dorë, madje vlerësoj se ajo që e kam mësuar gjatë muajve të fundit asnjëherë nuk do të kisha patur mundësi ta

lexoj në libër prej 700 faqeve sikur para dhënies së provimit. Megjithatë mund të them se jam pjesë e një gjenerate më të re e cila është e verbuar nga paratë dhe fama. Besoj se shumica e studentëve të moshës sime fillimisht do të tentojnë të bëhen pjesë e PR-it qeveritar apo zëdhënës.

Një pjesë e tyre sigurisht se do të zgjedhin stabilitet kohor dhe do të vendosin të bëhen “krijues përmbajtjesh”, e jo gazetarë pasi që kjo do tu sjellë më shumë përfitim. Unë kam vendosur të bëhem gazetarë dhe çdo ditë tentoj që të krijoj të vërtetë. Kjo punë kërkon të heqësh dorë nga shumë gjëra por ofron shumë kënaqësi kur dihet se po kontribuoni për të mirën e përgjithshme. Sigurisht që vlerësoj se gazetarët meritojnë që për punën e tyre të paguhen PR, krijues përmbajtjesh apo zëdhënës, kush do të mbetet për të informuar në mënyrë transparente?

### **SUNAI SABRIOSKI, gazetar (28)**



Lajm, koment, artikull, kolumnë, feature, fejtton, reportazh, lajm në vazhdim, raport, intervistë, njoftim për shtyp, konferencë për shtyp, dhe sigurisht piramida e përmbysur dhe ai rregull i artë gazetaresk pesë plus një? Këto janë disa prej bazave të gazetarisë që dalin prej ligjëratave të përditshme. Por, çfarë ndodhë në praktikë? Kjo pyetje e hidhur apo trishtuese me të cilën ballafaqohen gazetarët e rinj, ata që kanë vendosur të merren me këtë profesion duke vendosur të studiojnë në mënyrë që më vonë të vazhdojnë të punojnë. Por ka një por të madhe mes

filmave amerikan dhe realitetit, sidomos në Maqedoninë e Veriut.

Përse, pyetja epistemologjike e cila duhet të jetë pyetja më e përdorur ende pa vendosur për lundrim në ujërat e gazetarisë, sidomos aty ku ka vetëm lundruer e jo edhe kapitenë, kapitenë ekzistojnë dhe sipas zakonisht ato do të duhej të luftojnë për mbijetesë të ekuipazhit, apo ekipit. Kjo ndoshta është një teori që është bllokuar diku në kohën e Acta Diurna Populi Romani nga viti 59 para erës sonë, pastaj nëpërmjet Lord Northklifit dhe Xhozef Pulicerit duke mendjuar faktin tashmë jemi

në vitin 2021. Kjo vetvetiu flet se gjërat duhej të ndryshojnë qëmoti. Studentëve të gazetarisë duhet tu jepet trajtim adekuat nëpër sistemin e funksionimit të gazetarisë, tu tregohet se nga teoria në praktike, respektivisht nga amfiteatri në terren ka shumë dallime të mëdha, dhe duhet tu tregohen sfidat në mënyrë që të mos ballafaqohen me problemin që të bëhen pres agjentë në të ardhmen.

Realiteti i parë duhej të ishte ura lidhëse mes gazetarit të ri dhe mentorit apo redaktorit, i cili duhet që të ju udhëheqë nëpër realitetin e botës së hidhur që është zgjedhur të jetohet.

Hyrja e të rinjve në gazetari me shpresa për tu bërë gazetarë në të ardhmen, është lënë në zgjedhje të rastësishme, apo jo rrallë herë bëhen gazetarë sa për të mbushur minutazhin nëpërmjet formës dhe jo përmbajtjes. Gjithçka fillon me konceptin e diktuar nga disa qëllime “të pashkruara” komerciale për të qenë In, apo në rrjedhë me ngjarjet. Kështu një gazetar i ri duhet ti nënshtrohet një praktike të jashtëzakonshme që duhet ta ketë krijuar çdo medium i cili duhet të merret në mënyrë të vazhdueshme me krijimin e mendimit publik ku përparësi kanë qytetarët që duhet të dominojnë.

Praktika është bërë thujse e padukshme dhe e panevojshme në botën tonë mediatike pluraliste. Rrallë kush e ka mundësinë që para se të fillojë të krijojë mendimin publik të ketë një mentor, kjo pasi shumicën e kohës lihet siç thonë të moshuarit lejohet që “koha ta kalitë” apo formojë.

Filtri më i rëndësishëm për secilin gazetar fillestar duhet të jetë praktika e vendosur nga secili medium, pavarësisht se a bëhet fjalë për mediet tradicionale apo ato të reja. Secilit gazetar të ri duhet ti mundësohet që ti mësojë teknikat bazë dhe të thellohet tek përmbajtja dhe forma. Rasti më i shpeshtë është devaluimi i profesionit – mbajtja e mikrofonit apo diktafonit, gjë që është një proces degutant për zhvillimin e profesionit nëse paraprakisht nuk theksohet thellësia e zhvillimit të profesionit, të mos lejohet që të shndërrohet në mbajtësin e ardhshëm të mikrofonit i cili do të ishte i pazëshëm në rolin e përkujtuesit të Qeverisë me secilën temë që është apo duhet të jetë e një rëndësie thelbësore gjatë formimit të ndonjë mendimi i cili pastaj shndërrohet në mesazh deri tek pranuesi përfundimtar – qytetari.

Çdo medium duhet të vendosë një sistem ku secili që do të fillojë karrierën e gazetari do të kalonte disa metoda themelore për krijimin e aftësive për themelin e ardhshëm në demokracinë që do ta ruajë. Praktikë kjo që përveç teknikave të shprehjes dhe shkrimit, do të mundësojë aftësimin me rregullimin teknik të produktit mediatik, këtu mendoj për shprehjen multimediale që e imponon era digjitale në të cilën është thelluar profesionit i gazetarisë.



Gjëja e dytë është pamundësia e gazetarëve për tu trajnuar apo kualifikuar më shumë gjatë ushtrimit të profesionit. Më së shpeshti gazetarët nuk kanë mundësi që të marrin pjesë nëpër trajnime, seminare, shkolla verore apo praktika që do të ishin rëndësi e veçantë si për gazetarin ashtu edhe për mediumin në të cilin punon gazetari.

Mediumi duhet të kujdeset që gazetari i tij apo punonjësi mediatik të vazhdojë me ndjekjen e rrjedhave dhe risive të kohës në profesion edhe atë nëpërmjet veprimeve të përmendura më lartë për mbindërtim. Shumicën e kohës gazetarët nuk kanë mundësi që vetë të marrin pjesë nëpër trajnime për mbindërtim për shkak të kohës së pakët dhe mungesës së mjeteve financiare, prandaj mediumi duhet të ndajë mjete shtesë financiare që nuk do ta prekin pagën e tyre e cila gjithsesi nuk është e mjaftueshme për mbindërtim në karrierë.

Përnjëherë ka filluar të zhduket nevoja për ofrimin e kualitetit, dhe po shërbehet kuantitet. Gazetarit i kërkohet që të jetë në dispozicion 24/7 që sipas ndonjë rregulli të pashkruar edhe do duhej të ishte ashtu, por në realitet askush nuk mban llogari për aftësinë psikofizike të gazetarot i cili çdo ditë është në detyrë të punës. Përnjëherë kërkohen tema për të cilat gazetari nuk ka kohë të mendojë pasi tashmë ka hyrë në makinerinë në të cilën nuk zgjidhet kualiteti por është me rëndësi që të silllet ndonjë tekst i cili do të shërbejë si satisfaksion për tu mbushur përmbajtja pasi që opinionin nuk mund të "tolerojë". Përnjëherë redaktori harron mundin e kolegut gazetar dhe kështu nuk mban as llogari për objektivitetin. Shumicën e kohës pritet që hapësirën mediatike ta plotësojnë vetë gazetarët, dhe këtu diku humbet edhe roli i redaktori i cili është më i vlerësuar se sa ai i gazetarit i cili vazhdimisht ka qëndruar në bërjen e detyrës.

Përnjëherë të gjithë kanë apetite për tu bërë redaktor, pa menduar se ai pozicion ka shumë peshë dhe kështu të njëjtit vendosën në "piedestal" duke bërë tentativë për ndonjë farë redaktimi.

Gazetari përnjëherë e humb lirinë e tij, identitetin e tij – nuk njihet, reaktori ka vendosur që ta "redaktojë" por në fakt ajo që bën është fshirja e mundit të gazetarit duke ngopur apetitin dhe egon e tij duke menduar se nëse e ndryshon fjalinë apo renditjen e fjalive me një gjuhë burokratike, ka arritur të bëjë redaktimin mbi gazetarin i cili shkrihet dhe bëhet i njëjtë. Për një moment publiku mendon se në këtë botë pluraliste mediatike punon vetëm një gazetar pasi që gjithçka është e njëjtë, pa tentativë për të ofruar kualitet dhe shumëllojshmëri. Fjalori është thujse identik dhe me këtë edhe gazetaria pasi që kështu ka vendosur redaktori! Flasin për etikë ndërsa e shkelin etikën personale. Për fat të keq me disa redaktorë është tejet e rëndë të vendoset komunikim pasi nuk kanë mirëkuptim.

Kështu nëpër një sistem absurd me liri të kufizuar të shprehjes dhe me paga të ulëta, gazetarët e rinj në shtet gjithnjë e më shumë e lënë profesionin. Entuziazmi i tyre për të mbrojtur interesin publik po zhduket për shkak të ndodhive shoqërore dhe përgatitjen e pamjaftueshme për “Botën reale të medieve”

## DAVID ILIESKI, hulumtues dhe producent (24)



Kontaktin e parë të cilin e kam patur me gazetarinë ishte gjatë përpunimit të emisionit për të rinj “Krik”. Projekti ishte financuar nga organizata për zhvillim ndërkombëtar e BBC-së në bashkëpunim me “televizionin 24” ku emetohej sezoni i parë i serialit.

Kur në vitin 2017 mikja ime e fëmijërisë që është gazetare, Denica Çadikovska më propozoi që të aplikojmë me ide për emision televiziv për të rinj, aspak nuk kam shpresuar se ky projekt do të ndryshojë përgjithmonë rrugën time në karrierë. Deri atëherë nuk kam patur asnjë përvojë me gazetarinë dhe produksionin televiziv. Isha viti i dytë në studimet deridiplomike në një fakultet që nuk kishte lidhje me këtë sfidë të re.

Kishim ide konkrete se si duam ta realizojmë këtë produkt. Fakti se në atë moment nëpër televizionet e Maqedonisë por edhe në platformat mediatike online thuajse nuk ekzistonte ndonjë program që adreson tema rinore, dhe paralelisht me këtë, nëpërmjet rrjeteve sociale dhe video platformave globale si Youtube ishim vazhdimisht të eksponuar në përmbajtje që na drejtohej neve, dhe më së shpeshti kjo ishte vepër e moshatarëve tanë në botë, deshëm që të bëjmë diçka që do të jetë e re dhe do të jetë e jona, e jo e re dhe e huaj.

Gjatë përgatitjes së aplikimit dhe më tej edhe produksionit të serialit, e kishim si mentor gazetaren shumë vjeçare dhe themeluesen e IRL, Sashka Cvetkovska. Kur filluam ta përpunojmë idenë fillestare për herë të parë u ballafaquam edhe me realitetin e medieve në Maqedoninë e Veriut. Me të vërtetën se të rinjtë në shoqërinë tonë gjithnjë kanë qenë të marginalizuar dhe se interesat e të rinjve nuk janë të përfaqësuara në

mënyrë të barabartë apo aspak në mediet publike, sidomos tek mediet mainstream. Kjo na shtyu të mendojmë në atë drejtim se mund të krijojmë projekt për shoqëri inkluzive me të rinj të përgjegjshëm të cilët do të kenë liri të shprehjes dhe do të jenë të kyçur në mënyrë direkte në procesin e sjelljes së vendimeve.

Vërtetë kishim shpresë se ky projekt do të jetë fillimi i këtyre ndryshimeve. Se me vendosjen e standardeve të reja, do të dëshmojmë se të rinjtë mund të marrin pjesë në krijimin e përmbajtjeve në gjuhën maqedonase dhe që do të jetë e shikuar aq sa ato përmbajtje në të cilat ishim të eksponuar për çdo ditë nëpërmjet medieve globale.

Sezoni i parë i “Krik” apo 12 episodat në kohëzgjatje prej 30 minuash, i kemi përgatitur me një ekip prej pesë të rinjve të cilët atëherë nuk kanë patur përvojë direkte me produksion të programit televiziv. Tre gazetarë mes të cilëve edhe unë, dhe dy punonjës filmi respektivisht regjisorë, kameramanë dhe skenaristë të serialit. Të rinj të cilët vinim nga sfera të ndryshme me qëllim që të bëjmë kombinim të informacioneve kualitative dhe shfaqjes vizuale interaktive të informacioneve.

Produksionin e këtij seriali e kemi bërë me mbështetje të televizionit 24 por si një produkt i pavarur në vetë televizionin. Shpejtë pasi që erdhëm në televizion dhe pasi nisëm me produksionin e serialit, e kuptuam se ekziston një dallim i madh mes asaj që ne dëshironim ta bënim me “Krik” dhe ajo çfarë ndoshte në produksionin e programit në televizion. Shumica e kolegëve më të vjetër në televizion nuk i kushtonin shumë rëndësi asaj se çfarë është kualiteti i produksionit. Neve na shihnin ndryshe. Sidomos gjatë fillimit të punës para se ta realizojmë episodin e parë nëse mund të them na shihnin me mos besim. Edhe pse në televizion kishte kolegë të cilët na ofruan ndihmë gjatë krijimit të serialit.

Ishim të vetëdijshëm që ndoshta na mungon përvoja të cilët e kishin kolegët më të vjetër. Por, ajo që kishim ne ishte entuziazëm dhe vizionin e moshatarëve tanë të cilët edhe ishin publiku jonë që e kishim si qëllim. Megjithatë ekzistonte rrezik që si gazetar të rinj do të kemi problem me qasjen deri tek informacionet e nevojshme dhe mënyrën se si të njëjtat do të përpunohen. Me qëllim që ta kompensojmë përvojën që na mungon, në mënyrë të rregullt konsultoheshim me kolegët gazetarë që ishin më me përvojë, që pranuan të na japin mbështetje dhe mentorim.. Bëhet fjalë për Sashka Cvetkovskën dhe Laboratorin e gazetarëve hulumtues IRL. Të gjithë këto komponenta arritën që ta krijojnë këtë produkt, (diçka e mirë për Krik). Ndjenja që kishim mundësi që vetë ti zgjedhim temat që i përpunonim, por edhe mënyra se do ti rrëfejme këto tema, na dha një ndjenjë më ndryshe se me mendim ndryshe dhe nevojat e tona si të rinj, mund të japim kontribut për ndryshime të rëndësishme në drejtim të përmirësimit të kualitetit të jetës së të rinjve në Maqedoninë e Veriut.

Pasi që mbaroi sezoni i parë i "Krik" deshëm që këtë produkt ta ndajmë nga televizioni dhe ta bëjmë platformë të pavarur mediatike për të rinj. Derisa tentonim të siguronim mjete financiare për të vazhduar me punën tonë, proces për të cilin nuk e kam menduar se do të jetë aq i komplikuar, Cvetkovska na ofroi që këtë gjë ta bëjmë nga zyrat e IRL-së. Sigurimi i mjeteve për emisionin "Krik" u dëshmuar të jetë thuajse proces i pamundur. Prandaj pas disa muajsh punë nga zyrat e IRL-së puna jonë kaloi si gazetarë praktikantë të IRL-së.

Atëherë për herë të parë u ballafaqova me punën e storjeve hulumtuese, punë që kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në gazetari. Storja më e madhe që kam patur mundësinë ta punoj, falë qasjes që morrëm në IRL që të punojmë në storje që i trajtonin kolegët më me përvojë, ishte çështja e pronës së ngrirë të partisë VMRO DPMNE nga ana e Prokurorisë Speciale. Kjo storje u publikua në bashkëpunim me Projektin ndërkombëtar për raportim të krimit të organizuar dhe korrupsionit, OCCRP ku IRL është anëtare.

Derisa punoja në këtë storje, kisha mundësinë që gjatë kycjes direkte ta ndjekë procesin e punës për një storje hulumtuese me standardet më të larta ndërkombëtare. Duke filluar prej mënyrës së mbledhjes së informacioneve e pastaj edhe mënyrës së përpunimit, e deri tek vendosja e hipotezës dhe qasjes që rrëfimi të prezantohet sa më mirë. Gazetare e storjes ishte Maja Jovanovska, ndërsa Sashka Cvetkovska ishte redaktore. Detyra ime ishte që të asistoj në përpunimin e të dhënave për lokacionet, numrin dhe vlerën e pronës së VMRO DPMNE-së.

Ndjenja e shkaktuar nga dalimi i punës mes kësaj storjeje në IRL dhe mënyrës së punës së gazetarëve në televizion, është diçka që ka luajtur një rol shumë të madh në atë se si sot e shoh unë gazetarinë. Dhe kjo është një prej arsyeve kryesore përse kam mbetur në këtë profesion. Ekziston standard i diçkaje që është e jona (dhe e re) që mund të jetë konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar.

Gjëja e dytë që më ka mundësuar të ndërtohem në IRL si profesionist i ri, ishte liria për të kontribuar me ide për hulumtime. Mundësia që temat të burojnë prej neve gazetarëve të rinj, ishte mundësi për adresimin e problemeve të gjeneratës sonë. Kështu pasi vetëm disa muaj ardhje në IRL, ma dhanë mundësinë që të punoj në storjen time të parë hulumtuese së bashku me kolegen me përvojë Aleksandra Denkovska. "Bisha të privilejuara": Kaos dhe paligjshmëri në klubet e natës në Parkun e Qytetit". Vërtetë është shumë sfiduese kur punoni në diçka që i shqetëson njerëzit e fuqishëm. Dhe kështu filloni të mendoni se ndoshta ka kuptim që të mbeteni në gazetari.

Një vit më vonë kur tashmë ishte e qartë se projekti rinor “Krik” për fat të keq ishte platformë që nuk do të arrijë të vazhdojë me punë për shkak të mundësive të vogla për gjetjen e burimeve financiare, ndërsa puna në IRL na ofroi mundësi dhe emocione të cilat nuk i kam pritur asnjëherë, mbetëm të punojmë si reporterë të rinj në ekipin e IRL-së. Atëherë e kisha mundësinë që të jem pjesë e programit të parë “OCCRP Research Fellowship” për arritjen e aftësive të avancuara për kërkim dhe hulumtim.

Falë asaj që IRL bashkëpunon me këtë rrjet, kisha mundësi që të pajisem me këto aftësi nëpërmjet punës praktike me ekipin e “Investigative Dashboard”, që është një servis i OCCRP që i ndihmon gazetarët hulumtues që janë pjesë e rrjetit për të bërë hulumtime më të shpejta dhe më efikase. Pasi që e mbarova këtë program, u bëra pjesë edhe e vetë ekipit si përfaqësuesi i parë i Laboratorit për gazetari hulumtues në “Investigative Dashboard”.

Unë ende punoj si gazetar në IRL por ndihmoj edhe në organizatën amë (OCCRP) si pjesë e ekipit ndërkombëtar të hulumtuesve profesional dhe specialistëve për të dhëna që ndihmon për gjetjen e njerëzve, kompanive dhe mjeteve – si anije dhe aeroplanë gjithandej botës, por edhe për të kërkuar baza të avancuara që do tu ndihmojnë gazetarëve nga e gjithë bota që sa më shpejtë të vijnë deri tek dokumentet për storjet e tyre.

## ● LLUKA BLLAZHEV, dizajner grafik (26)



Angazhimi im në media ka filluar me ftesën për tu bërë pjesë e projektit “Redaksi mobile (të lëvizshme)”, më saktësisht në fushatën “Lufto me ne” që është zbatuar nga IRL. Në atë momentin filloi edhe storja ime duke bashkuar atë në çfarë jam i zoti me atë në të cilën besoj dhe dua ta ndryshoj në shtetin tonë.

Mesazhin që e dërgoi projekti jonë i parë ishte vendimtari dhe që më shtyu të interesohem për tiu bashkangjitur ekipit, ndërsa këmbëngulja, guximi dhe vizioni i të gjithëve në IRL, ishte ajo që më bëri krenar që jam ende pjesë e ekipit.

Fillimet në IRL i shin sikur ato fillime me të cilat hyn në të panjohurën. Që prej momentit të par pashë miqësi, shpresë dhe pranim. Besoja në atë që tentonin ta ndryshonin, dhe kështu shpresoja që do të vazhdoja me angazhimin tim të punës.

Jam falënderues që jam pjesë e një ekipi të tillë ku në mënyrë konstante është e pashmangshme të hapni horizontet, por edhe çdo ditë ndërtoj veten në aspekt të dizajnerit. Prej fillimit deri tani mund të vërej shumë ndryshime pozitive tek vetja, çdo ditë pasurohem me dije të reja, dhe kam më shumë vetëdije për gjithë situatën politike dhe shoqërore të Maqedonisë së Veriut.

Sa i përket sinergjisë që e kanë fjala e shkruar dhe pjesa vizuale, vlerësoj se nëpërmjet dizajneve mund të rrëfehët e gjithë storja.

Dizajni e ka fillimin e tij, mesin dhe përfundimin. Do thoja që poashtu është tejet me rëndësi që ta keni lirinë e shprehjes artistike të cilën unë e kam gjetur si pjesë e ekipit të IRL-së.

Qëllimi im personal është që secili dizajn që ketë ndikim tek njerëzit aq sa ka ndikim storja gazetareske pasi që secili dizajn është i përpunuar me shumë dashuri dhe besim në atë që e bëmë. Kur punon për IRL-në kreativiteti nuk ka fund.

Besoj që mediet duhet tu japin më shumë hapësirë të rinjve që të shprehen, të investojnë tek ata dhe ti edukojnë për tema të cilat na tangojnë të gjithë neve në përditshmëri.

Apeloj deri tek rinjtë që të angazhohen më shumë për ndryshime për një të ardhme më të mirë, ta thonë storjen e tyre me zë për të gjithë neve dhe ata që do të vijnë më pas.

Ndryshimi është në duart e tona dhe nëse ne heqim dorë atëherë ndryshimi nuk do të vijë kurrë. Shpresoj të jem pjesë e kësaj storjeje edhe shumë gjatë dhe se edhe shumë njerëz të tjerë do të luftojnë bashkë me ne.



# Rezyme

---





## Rezyme

---

### **Gazetarët e rinj si shans për erën e re të medieve me integritet dhe ndikim**

Në dekadën e fundit, e sidomos në tre vitet e fundit, shumë prej strategjive kyçe të programeve donatore për mbështetje e kanë vendosur gazetarinë rinore lartë në listën e prioritetëve. Nëpërmjet tyre janë bërë më të qasshme dhe më prezente trajnimet e organizatave mediatike, programet mediatike në redaksitë lokale dhe nëpërmjet gazetave shkollore, podkasteve dhe platformave të tjera digjitale, sot në shtetet e zhvilluara në botë të rinjtë janë të kyçur në prodhimin e gazetarisë kualitative në mënyrë që po bëhet gjithnjë më e dukshme dhe po vlerësohet si jetike për mbijetesën e bashkësive. Gazetaria rinore është zgjidhja e problemeve dhe platformë për idetë të cilat do ti transformojnë bashkësitë, qytetet, shtetet, botën, në kohën e tyre dhe në të ardhmen.

Gazetarët dhe mediet duhet të insistojnë edhe më shumë për bashkëpunim me institucionet arsimore dhe të rinjtë e bashkësive, pasi që prej kësaj do të ketë përfitim potencial e gjithë shoqëria. Jo vetëm që ekziston nevoja për mbështetje të gazetarëve të rinj në bashkësi që të raportojnë për problemet që i prekin ata, por kjo është edhe një mundësi tejet e madhe që gazetarëve të rinj tu jepen detyra që do të promovojnë dialogun dhe vetëdijen për dallime në nivel global. Të rinjtë e ditëve të sodit asi asnjë gjeneratë më parë, e kanë mundësinë që ti diskutojnë produktet e tyre bashkë me moshatarët gjithandej botës. Të përdoren të rinjtë në produksionin e produkteve gazetareske është një gjë, por mundësia më e madhe për nxitjen e ndryshimeve nëpërmjet gazetarisë qëndron në lidhjen globale: të përgatitet një gjeneratë e tërë e qytetarëve në botë të cilët do të kenë aftësi, kuptim dhe guxim për të zgjidhur problemet e ditëve të sotme në kohën e tyre.

Ana pozitive e profesionit të gazetarisë në kontekst të përgjithshëm është pikërisht kjo, liria dhe hapja ndaj secilit që ka dëshirë dhe shans për të tentuar që të bëhet gazetar si dhe mundësia që të ndikojë në përmirësimin e shoqërisë dhe kualitetit të jetës më të mirë të qytetarë, kjo është një prej motiveve për të filluar me karrierën e gazetarit.

Për nevojat e këtij publikimi është folur me profesorë dhe të punësuar nga tre universitete shtetërore të cilat kanë reparte për gazetari edhe në Shkup, Shtip dhe Tetovë. Përveç kësaj analizohet edhe një pyetësor që i llojit gjysmë të hapur me tetë pyetje, që është realizuar me përgjigjet e 26 gazetarëve të rinj gjatë muajit mars të vitit 2021.

Gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit nëpërmjet trajnimeve të programeve të BIRN-it, kanë kaluar qindra gazetarë të rajonit, shumica prej të cilëve tani janë redaktorë dhe gazetarë në media udhëheqëse, televizione, portale, dhe që në biografi kanë shpërblime prestigjioze dhe mirënjohje. Bursa ballkanike për ekselencë në gazetari, program që prej vitit 2007 përfshin nga dhjetë gazetarë të rajonit në vit që punojnë në tema dhe analiza thelbësore, përfshin një trajnim një javor të detajuar që shumicën e kohës mbahet në Vienë apo Berlin. Para pandemisë me virusin Korona, kjo ka qenë një ndihmesë e konsiderueshme financiare dhe redaktoriale për përpunimin e një storjeje në periudhë disa mujore. Shumë gazetarë që kanë qenë pjesë e këtij programi thonë se do ta zgjidhnin si më të mirin. Shanset për udhëtim, njohjet, shoqërimi, shkëmbimi i përvojave me kolegë nga rajoni por vizita e redaksive nëpër shtete të tjera, kontaktet me gazetarë të ndryshëm por edhe krijimi i rrjetit të kontakteve në rajon dhe Evropë, dhe shoqëritë shumë vjeçare. Për shoqëritë në të cilat kryesisht ka pak interes dhe aq më pak njohuri se çfarë bëhet përtej kufijve të shtetit, ky lloj i programeve ofrojnë mundësi të shkëlqyer për mbindërtim.

Rëndësi e veçantë është që gazetarët e rinj të mësojnë të ashtuquajturën shkollë e vjetër për etikë ndërsa organizatat formale dhe joformale arsimore të ju mundësojnë të rinjve që ti kenë storjet e tyre me integritet, efektivitet dhe mbulim gjithëpërfshirës. Vetëm gazetarë të trajnuar mirë dhe të motivuar shumë mund ta luajnë rolin e rojtarëve të së vërtetës dhe të jenë sytë e vërtetë të qytetarëve në një kohë kur shumica e qytetarëve janë apatik.

Në Maqedoninë e Veriut gazetarët dhe redaktorët e rinj të cilët në dekadën e fundit kanë punuar me "Organised Crime and Corruption Reporting Project – OCCRP", me fokus arritjen e aftësive analitike dhe kritike për zbulimin e krimit dhe korrupsionit, sot në një redaksi të vogël në Shkup, pa ndonjë trajnim formal, dhe vetëm me punë praktike dhe nxitjen e gazetarisë së guximshme, trajnojnë një gjeneratë të re punonjësve mediatik të cilët duhet të japin kontribut në luftën globale kundër krimit dhe korrupsionit si një prej kërcënimeve më të mëdha ndaj demokracisë.

Përvoja e tyre në këtë publikim është prezantuar si një koncept unikat i cili i bashkon përvojat e redaktorëve të rinj dhe gazetarëve të cilët janë trajnuar dhe kanë punuar në tema rajonale dhe globale në të cilat kanë punuar edhe bashkëmoshatarët e tyre në Evropë dhe botë. Sot nëpërmjet qendrës lokale të Laboratorit të reporterëve hulumtues, trajnohen forcat e reja që janë në fazat e para të karrierave të tyre me synim që të krijohen mendje konkurruese kritike të cilat do ta kuptojnë forcën e medieve dhe do ti vendosin standardet e ardhshme krahas krahas moshatarëve të tyre në botë.

Si një prej konkluzave në të cilat na çon ky publikim është ai se roli i gazetarëve të rinj në industrinë mediatike është i një rëndësie të veçantë, prandaj është me rëndësi që mediet të kenë mekanizma të tërheqjen dhe motivimin e punës së kuadrove të reja. Edukimi në vendin e punës por edhe mundësia që mediat të mundësojnë një pjesë e gazetarëve të rinj të marrin pjesë në trajnime të jashtme të organizuara nga ana e organizatave të sferës së gazetarisë dhe atyre qytetare, është e një rëndësie tejet të veçantë për zhvillimin profesional të punonjësve të ri mediatik.

Në kushte kur profesioni i gazetarisë ballafaqohet me mungesë të kuadrit të ri, është e nevojshme që menaxhmenti të mendojë se si ti nxisë gazetarët e rinj profesionistë që të vazhdojnë të jenë aktiv në mediet e tyre. Institucionet e larta arsimore në shtet nga ana tjetër duhet ti ndjekin trendet moderne në profesion dhe në këtë mënyrë duhet të krijojnë kurrikula të cilat do të tërheqin përsëri studentë të ri në gazetari. Kjo do të kontribuojë që gazetarët e rinj kritik të vazhdojnë të jenë profesional pasi që të tillë janë të nevojshëm për promovimin dhe mbrojtjen e interesit publik.

ISBN 978-608-4648-64-2  
ISBN 978-608-4969-00-6